



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 25/63 Prot

Tiranë, më 09/02/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT THODHORI GRAVANI

Nr. , datë 26.01.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Edona Dushaj	Kryesuese
Enton Radovani	Relator
Kleada Mersinllari	Anëtare

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtare e Sekretariatit Teknik, znj. Ersila Kalaja, në datën 26.01.2024 ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Thodhori Stefan Gravani**, me funksion aktual Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar, në Departamentin për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018** “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi relatimin e relatorit të çështjes Enton Radovani; dëgjoi subjektin e vlerësimit, **Thodhori Gravani**, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 26.01.2024, kërkoi konfirmimin e tij në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Protokollit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në tre kriteret e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit 12/2018, i ndryshuar,

V Ë R E N:





I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi z. Thodhori Gravani është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023 si Drejtor i Drejtorisë së Protokollit në Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
3. Subjekti i vlerësimit, z. **Thodhori Gravani** iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7, datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit sipas ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 28/1, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: z. Enton Radovani, **Relator**, znj. Edona Dushaj, **Kryesues**, dhe znj. Kleada Mersinllari **Anëtar**.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr. 27/2, datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani.
6. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar nr.28/6 prot., datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është

bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore në datën 24.04.2023, e cila është protokolluar me nr. 28/10, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit të mbështetur në nenet 33/1, nenin 42, nenin 46 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse deklaratimet e subjektit të vlerësimit, si më poshtë vijon:
 - a. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërgua pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin shoqërues;
 - b. me shkresën nr.*** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit deklaratën e vlerësimit të aftësive profesionale;
 - c. me shkresën nr. *** prot, datë 19.04.2023, ka dërguar pranë Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 - ✚ vlerësimin e pasurisë;
 - ✚ kontrollin e figurës;
 - ✚ vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligji nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”
 - c. Ligji nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”
 - d. Ligji nr.49/2012 “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”
 - e. Ligji nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”
 - f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr. 7 datë 17.01.2023 “Për procedurat e hedhjes së shortit”
 - g. Rregulloren nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”

h. duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në Ministrinë e Brendshme që janë:



-  *Deklarata e Pasurisë,*
-  *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
-  *Formulari i Vlerësimit Profesional*
-  *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet,*

- i. Raportet përmbledhëse të ILDKPKI-së, Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit në AMP, dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- l. ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

13. Trupa e vlerësimit, 08.01.2024, pasi dëgjoji relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani , me Vendimin nr. 22, datë 08.01.2024, vendosi;

a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. **Thodhori Gravani**

b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:

-  *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
-  *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*

c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 3, pika 12 dhe 14, e Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

15. Në datën 23.01.2024, trupa e vlerësimit, njoftoi subjektin e vlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 26.01.2024 ora 10:00, në ambiente e sallës së mbledhjes së Ministrisë së Brendshme, në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit kishte zgjedhur të mos përfaqësohej me mbrojtës ligjor në këtë seancë. Në fund të seancës dëgjimore të datës 26.01.2023, subjekti i vlerësimit z. Thodhori Gravani kërkoi konfirmimin në detyrë. Në datën 26.01.2024, trupa e vlerësimit shpalli vendimin.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

Me subjektin e vlerësimit është komunikuar me anë të postës elektronike, duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave. Subjekti i vlerësimit z. Thodhori Gravani, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të vlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë hetimit.

IV. VLERËSIMI I PASURISË

16. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
17. Në zbatim të nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. Thodhori Stefan Gravani, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 08.03.2023, brenda afateve ligjore. Formulari i pasurisë ka nr. 18 index, viti 2023.
18. Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
19. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.

20. Gjithashtu, trupa e vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaratimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar; raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34; shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave; mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

21. Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- ✚ deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;
- ✚ raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI;
- ✚ provat shkresore/dokumente të vena në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;
- ✚ dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si dhe përgjigjet e pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

22. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve, në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ verifikimin e burimit/eve të krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

23. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja;

ILDKPKI-ja, në përputhje me Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport¹, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani, ku është konstatuar se:

- ✓ deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- ✓ nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ✓ nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- ✓ nuk është kryer deklarim i rremë;
- ✓ subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

¹ Raporti nr. 6/57, datë 03.10.2023, i ILDKPKI-së.

A. PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

24. Bazuar në nenin 34, të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nenit 34 të ligjit 12/2018; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit; (dh) deklaratimet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur, (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllimin evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (ik) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

V. DEKLARIMI I PASURIVE

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria nr. 1

✚ Apartament banimi 122 m², Lagjja ***, Vlorë. Viti i blerjes 2004. Vlera: 1.900.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.


Burimi i krijimit: Nga shitja e banesës së parë (banesa e prenotuar në vitin 1999, hipotekuar në vitin 2001 me të ardhurat pas emigracionit dhe biznesit familjar, shitur në vitin 2004).

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme - apartament banimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.1.2004, nënshkruar ndërmjet palës shitëse F.R. e E.R. dhe palës blerëse Thodhori Gravani, të një apartamenti me sip. 122 m², ndodhur në lagjen "****", Vlorë. Çmimi i shitjes në vlerën 1.900.000 lekë, është shlyer nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale.

- Vërtetim nga dokumentet hipoteko të ZVRPP Vlorë, me anë të së cilës figuron e regjistruar në emër të F.R., pasuria apartament me nr. ***, ZK ***, ndodhur në lagjen *** Vlorë. Data e lëshimit të vërtetimit 06.01.2004.
- Kontratë shitblerje e pasurisë së paluajtshme - apartament banimi nr. *** rep. nr. *** kol., datë 06.05.2004, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Thodhori Gravani dhe palës blerëse B.B., të një apartamenti ndodhur në lagjen "****" Vlorë, regjistruar me nr. *** ZK ***, pallati ***. Pasuria është fituar nga pala shitëse nëpërmjet kontratës nr.***rep., datë 01.04.1999. Vlera e shitjes së apartamentit 1.900.000 lekë, është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.
- Kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.10.2001, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Drejtoria e Policisë Vlorë (përfaqësuar me prokurë nga shtetasi K. Z.) dhe palës blerëse Thodhori Gravani, të një apartamenti me sip. 100 m², ndodhur në Rrugën "****", Vlorë. Çmimi i Shitjes në vlerën në emër të Thodhori Gravani, pasuria apartament me nr. ***, ZK ***, hyrje 11, pallati 1380, ndodhur në lagjen "****", Vlorë. Data e lëshimit të vërtetimit 06.11.2001.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

-  **ASHK Vlorë**, me postën elektronike datë 02.10.2023 konfirmon se në favor të subjektit Thodhori Gravani, rezulton e regjistruar pasuria ***, volum ***, faqe ***, ndodhur në zonën kadastrale ***, apartament me sipërfaqe 81.4 m², rivlerësuar në vlerën 5.030.520 lekë, përfituar me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12. 01.2004 me palë shitëse F. dhe E. R. konfirmon gjithashtu se pasuria nr. ***, ZK ***, është e llojit truall me sip. 440 m², dhe nuk është në pronësi të Thodhori Gravani, ndërsa pasuria ***, nuk është dhe nuk ka qenë në pronësi të Procedim Bank me shkresën nr. *** prot., datë 04.05.2023, konfirmon se shtetasi Thodhori Gravani ka patur llogari rrjedhëse dhe një kredi me vlerë 300.000 lekë. Kredia e mbyllur në vitin 2006, ndërsa llogaria në vitin 2011. Referuar lëvizjeve të llogarisë bashkëlidhur, rezulton se kredia me vlerë 300.000 lekë është disbursuar në datë. 20.05.2005.

Në deklaratën "Pas Largimit 2004", subjekti deklaroi pasurinë apartament me vlerë 4.000.000 lekë, burim të ardhurat nga emigracioni në Greqi.

Në proces-verbalin e datës 17.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se *"...ka nënshkruar kontratën e parë të shitblerjes nr. *** Rep, nr. *** Kol, datë 12.01.2004, nëpërmjet shitësit F. R. dhe E. R. dhe blerësit Thodhori Gravani, për banesën e ndodhur në lagjen "Pavarësia", nr. pasurie ***, Zona Kadastrale ***, në shumën prej 1.900.000 lekë. Ka kryer veprimin e detyrës noterial, konkretisht atë të nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., datë 06.05.2004, për pronën pasuri e paluajtshme apartament i ndodhur në lagjen "Pavarësia", me nr. pasurie ***, Zona Kadastrale ***, apartament banimi në pallatin nr. ***, me përbërje 3 dhoma, një kuzhinë e ambiente funksionale, shkalla e parë, kati i katërt, vërtetuar me Vërtetimin nr. ***, datë 20.12.2001,*

lëshuar nga ZRPP-Vlorë, ku ai në cilësinë e shitësit dhe njëkohësisht dhëndër i B.B., e ka shitur kë tij të fundit, kundrejt shumës prej 1.900.000 lekë”.

Në deklarinimin e bërë prej tij, në vazhdim ai sqaron se “...të ardhurat për blerjen e apartamentit referuar kontratës së shitblerjes nr. *** Rep, nr. ***Kol, datë 12.01.2004, kanë pasur si burim të ardhurat e krijuara nga shitblerja e kontratës nr. 73, 7 rep., datë 06.05.2004, pasi ka rënë dakord paraprakisht me vjehrrin B.B., i cili në të njëjtën periudhë kërkonte për të blerë një apartament, për shkak të arsyeve familjare, që bënin të pamundur qëndrimin e tij në apartamentin ku jetonte, kanë rënë dakord që vjehrrin ti parapaguajë për apartamentin të cilin ja shiti referuar kontratës së muajit maj 2004, dhe me vlerën e fondeve të marra paraprakisht dhe jashtë zyrës noteriale, të realizojë blerjen e apartamentit që lidhet me kontratën e shitblerjes në janar 2004”.

Më pas, derisa përfunduan punimet në apartamentin që është pronë e tij aktualisht, pra gjatë 4 muajve nga janari deri në maj 2004, ka qëndruar në shtëpinë që më pas do të bëhej e vjehrrit dhe në muajin maj 2004 u vendos banues në apartamentin për të cilin kishte realizuar kontratën e shit-blerjes në janar 2004.

Kjo është arsyeja që nënshkroi një kontratë shitblerje mes tij dhe vjehrrit, ku ligjëruan shitjen e apartamentit, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., datë 06.05.2004, në të cilën është përmendur që detyrimet monetare janë kryer jashtë zyrës noteriale, ashtu si kundër ka ndodhur realisht, duke mirë besuar në marrëdhënien familjare vjehërr-dhëndër.

Për apartamentin e blerë nga Drejtoria e Policisë Vlorë paraqiti kartelën e lëshuar nga ZVRPP Vlorë, e cila përmban edhe kontratën e blerjes datë 02.10.2001. Sqaroi se gjatë kësaj periudhe ai ka qenë pjesë e strukturave të Drejtorisë së Policisë Vlorë. Në atë periudhë ka patur një marrëveshje midis shoqërisë ndërtuese me përfaqësues shtetasin K.Z. dhe Drejtorisë së Policisë Vlorë, për ndërtimin e rreth 15 apartamenteve. Në kushtet që ka qenë me status i pastrehë, ka kërkuar të kryej blerjen e njërit prej tyre, në kosto relativisht më të ulët se tregu. Të gjitha apartamentet janë shitur tek kolegët e tij. Sqaroi se ka kërkuar dokumentacion pranë hipotekës për kontratën e vitit 1999 dhe i është dhënë në dispozicion praktika, e cila nuk e përmban këtë kontratë.

Në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.10.2001, në vlerën 1.800.000 lekë, sqaroi se kanë shërbyer të gjitha të ardhurat familjare, përgjatë gjithë kohës që ka qenë në marrëdhënie pune, nga emigracioni prej vitit 1993 -1995, si dhe nga aktiviteti privat që ka ushtruar në vitet 1995 - 1998. Veprimet e shit-blerjes së apartamentit janë kryer cash dhe nuk disponon mandate për pagesat e tyre.

Subjekti paraqiti:

- **Dokumentacioni hipotekor** për pasurinë me nr. ***, në emër të Drejtorisë së Policisë Vlorë, e cila përmban kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.10.2001 dhe certifikatën e pronësisë së apartamentit.
- **Deklaratë noteriale** nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2019, e shtetasve B.B. dhe D.B. (në cilësinë e të besuarës për ti lexuar dhe nënshkruar aktin zotit B.B.). Sipas

deklaratës, shtetasi B.B. konfirmon lidhjen familjare me shtetasin Thodhori Gravani, si dhe deklarën nënshkrimin e kontratës nr. *** rep., datë 6.5.2004, për blerjen e apartamentit të tij. Për blerjen nga ana e Thodhori Gravani të apartamentit tjetër, kanë dakordësuar pagimin paraprak të vlerës së shtëpisë 1.900.000 lekë, shumë e cila, kur të lidhej kontrata e shitjes, do të shërbente si çmimi i blerjes së apartamentit nga ana e B.B.. Shumën 1.900.000 lekë ja ka dhënë dhëndrit jashtë zyrës noteriale.

- **Vërtetim** datë 13.12.2019, nga Raiffeisen Bank, për D.B., e cila ka patur të depozituar në Bankën e Kursimeve shumë 3.703.381 lekë deri në datë 14.1.2004. Bashkëlidhur kartela e depozitimeve pranë Bankës së Kursimeve (1997 - 2004).
- **Kontratë** shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.1996, palë shitëse B.B, D.B, E.B. dhe palë blerëse Xh.M. të një banese të përbërë nga dy dhoma e kuzhine të ndodhur në Vllahinë, Vlorë. Çmimi i shitjes 400.000 lekë.

Në proces-verbalin e datës 27.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se lidhur me konfirmimin e pasurisë si regjistrim i përkohshëm në datë ***, me nr. ***, në emër të Thodhori Gravani, ndodhur në ZK ***, vol. ***, faqe ***, bëhet fjalë për rivlerësimin e apartamentit në Vlorë.

Lidhur me shpenzimet e mobilimit, sqaroi se *“...apartamenti në Vlorë i blerë në vitin 2001, është mobiluar në dy vitet e para dhe janë shpenzuar rreth 300.000 lekë. Një pjesë e këtij mobilimi është përdorur në apartamentin tjetër të blerë në vitin 2004 dhe përveç kësaj janë shpenzuar shtesë edhe rreth 400.000 lekë, në periudhën 2004 – 2005”*.

Subjekti paraqiti:

- Kërkesë nr. ***, datë 11.5.2017, pranë ASHK nga Thodhori Gravani, për rivlerësim të pasurisë nr. ***, ZIC ***. Bashkëlidhur ndodhet mandat pagesa në favor të ZVRPP Vlorë, në vlerën 1.800 lekë dhe 62.710 lekë për rivlerësimin e pasurisë.
- **Kartela e pasurisë së paluajtshme** nr. ***, ZK ***, apartament me sip. 81.4 m², regjistruar në datë. 06.05.2006, në emër të Thodhori Gravani. Në seksionin "D" të kartelës, përcaktohet rivlerësimi i pasurisë në datë 12.05.2017, në vlerën 5.030.520 lekë. **Në proces-verbalin e datës 02.10.2023**, subjekti sqaroi se referuar dokumentacionit të paraqitur dhe atij të konfirmuar nga rivlerësimi i pasurisë, diferenca e sipërfaqeve të apartamentit në Vlorë, është konstatuar dhe ka ndodhur pas rivlerësimit të apartamentit në vitin 2017, pas matjes fizike të tij. Është rivlerësuar sipërfaqja e ballkoneve dhe në tërësi e apartamentit, i cili përmban 2 dhoma dhe një kuzhinë. Në lidhje me ndryshimin e numrit të pasurisë deklaroi se ndryshimet janë kryer nga vetë hipoteka, pasi apartamenti është i njëjti.

Sqaron se në “Deklaratën Pas Largimit nga Funkzioni 2004”, ka deklaruar vlerën e tregut të apartamentit, në kushtet që kjo ishte deklarata e parë që plotësonte dhe nuk kishte njohuri.

Në proces-verbalin e datës 17.10.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *“...të ardhurat nga emigracioni janë realizuar me bashkëshorten e tij të parë, ndërsa ka filluar bashkëjetesën me Edlirën nga momenti i blerjes së dytë të apartamentit në Vlorë, rreth vitit 2002 dhe më pas është kryer martesë”*.

Sqaroi se kredia 300.000 lekë në Procredit Bank është marrë dhe përdorur për shpenzimet e mobilimit të apartamentit në Vlorë.

Konkluzion:

- ✓ Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se; Pasuria apartament me sip. 122 m² (sipas ASHK sip. 81.4 m²), në Vlorë me vlerë 1.900.000 lekë, është përfituar në 2004 me burim nga shitja e apartamentit me sip. 100 m², Vlorë (në të njëjtën vlerë). Apartamenti i është shitur vjehrrit të subjektit dhe shuma, sipas shpjegimeve, është dhënë paraprakisht, fakt i cili është dokumentuar me deklaratë noteriale (dokumentuar gjithashtu edhe mundësitë financiare për blerjen e tij nga ana e vjehrrit). Ky apartament, rezulton të jetë prenotuar në vitin 1999 dhe me kontratë shitje në vitin 2001, në vlerën 1.800.000 lekë, me burim të ardhurat familjare, përgjatë kohës që ka qenë në marrëdhënie pune, emigracioni prej vitit 1993 - 1995, si dhe aktiviteti privat në vitet 1995 - 1998. Subjekti ka dokumentuar qëndrimin në shtetin grek prej vitit 1993, punësimin e tij në Greqi për periudhën 1993 - 1995, regjistrimin si Person Fizik më datë 13.01.1995, por nuk rezultojnë të dhëna financiare të përfituara për periudhën. Gjithashtu, organet tatimore nuk konfirmojnë të ardhura nga aktiviteti privat për periudhën.
- ✓ **Konfirmohet** deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, lidhur me pronësinë e apartamentit me sip. 122 m², Lagjja Pavarësia, Vlorë, në emër të subjektit. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me sip. 81.4 m², konfirmuar nga ASHK.
- ✓ Rezultojnë shpenzime mobilimi për dy apartamentet e banimit në Vlorë (shitur/blerë), gjatë periudhës 2001 - 2005. në shumën totale rreth 700.000 lekë. Dokumentacioni lidhur me të ardhurat nga emigracioni dhe aktiviteti privat, është trajtuar më poshtë (rubrika të ardhurave).
- ✓ Pasuria apartament me sip. 122 m², në Vlorë. është përfituar me kontratë blerje në vitin 2004. me burim të ardhurat nga shitja, në të njëjtin vit të apartamentit me sip. 100 m², në Vlorë. me vlerë të njëjtë shitje/blerje.
- ✗ Për pasurinë apartament me sip. 100 m². në Vlorë, blerë në vitin 1999 - 2001 në vlerën 1.800.000 lekë. me burim të ardhurat nga emigracioni dhe aktiviteti privat rezulton se subjekti ka paraqitur dokumentacion të ligjshëm ligjor/financiar, i cili vërteton punësimin e tij në Greqi, **por nuk rezultojnë të dhëna financiare.**
- ✓ **Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie aplikohet neni 32 pika 1.1 të ligjit 12/2018 i ndryshuar, sepse ky aset është krijuar para vitit 2008.**

Pasuria nr. 2

- Apartament banimi në Selitë, Tiranë, sip. 107 m², blerë në vitin 2017. Vlera 10.689.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i të ardhurave: a) kredi bankare në Tirana Bank, b) kontratë huamarrje, c) nga të ardhurat personale.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Certifikate për vërtetim pronësie** të pasurisë apartament me sip. 107.1 m², regjistruar me nr. ***, në emër të Thodhori Gravani. Data e lëshimit 30.03.2017.
- **Certifikate për vërtetim pronësie** të pasurisë apartament me sip. 107.1 m², regjistruar me nr. ***, në emër të shoqërisë "Rinia " ShPK. Data e lëshimit 02.03.2016.
- **Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme** me kusht kreditimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.03.2017, nënshkruar ndërmjet palës shitëse shoqëria ndërtimore "Rinia 04" ShPK. dhe palës blerëse Thodhori Gravani, të një apartamenti me sip. 107.1 m², sip. verande 61.2 m², regjistruar me nr. ***, ndodhur në Selitë, Tiranë. Çmimi i shitjes në vlerën 10.689.000 lekë, do të likuidohet me këste. Kësti i parë 3.689.000 lekë është shlyer nëpërmjet llogarive bankare të palëve. Kësti i dytë 7.000.000 lekë do të likuidohet nga ana e blerësit në momentin e disbursimit në favor të kredisë bankare në emër të tyre dhe do të kalohet në llogarinë e noterit. Momenti i kalimit të pronësisë është data e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Blerësi brenda afatit prej 30 ditësh duhet të bëjë regjistrimin pranë ZVRPP, me qëllim ndryshimin e pronësisë, me kushtin që kartela e pasurisë të mbetet e bllokuar në favor të shoqërisë "Rinia 04" ShPK deri në momentin e shlyerjes së shumës së përcaktuar në këstin e dytë.
- **Kontratë huaje** nr. *** rep., nr. *** kol., datë 09.03.2017, huadhënësi B. B. dhe huamarrës Thodhori Gravani. Huadhënësi ka dhënë në formë huaje huamarrësit shumën prej 2.000.000 lekë. Huamarrësi deklaron se ka marrë në dorëzim këtë shumë dorazi, për afat 5 vjeçar. Shlyerja e kësaj huaje do të bëhet midis palëve me marrëveshje midis tyre brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Huaja është dhënë pa interes.
- **Kontratë kredie bankare hipotekore** nr. ***, datë 15.05.2017, nënshkruar ndërmjet palës kredi dhënëse Tirana Bank dhe palës kredi marrëse Thodhori Gravani e Edlira Gravani. Vlera e kredisë 7.000.000 lekë me qëllim për blerje apartamenti me sip. 107.1 m². Pjesëmarrja e kredi marrësit në këtë investim është në shumën 3.689.000 lekë. Afati i shlyerjes së kredisë 16 vite. Pagesa e kësaj kredie do të sigurohet nga hipoteka mbi pasurinë e paluajtshme të llojit apartament me sip. 107.1 m², regjistruar me nr. ***, në emër të Thodhori Gravani, Selitë, Tiranë.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot. datë 08.05.2023**, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Thodhori Gravani, në të cilën evidentohet: akumulimi i shumës 1.598.000 lekë, gjatë periudhës shkurt 2010 - mars 2017, depozitimi në datë 16.03.2017 i shumës 2.000.000 lekë me përshkrimin "depozitim sipas kontratës datë 09.03.2017, rep. 990 kol. ***"; transferimi i shumës 3.689.000 lekë, në favor të "Rinia 04" ShPK, me përshkrimin "likuidim kësti i parë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol. tërheqje e shumës 800.000 lekë, datë 05.12.2017 dhe të shumës 800.000 lekë.
- ✚ **Tirana Bank me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023**, konfirmon se shtetasi Thodhori Gravani ka llogari, si dhe është kredimarrës pranë bankës, çelur prej vitit 2017. Bashkëlidhur ndodhen lëvizjet e llogarisë, në të cilën evidentohet disbursimi i kredisë në 26.05.2017, me vlerë 7.000.000 lekë, si dhe transferimi i shumës 6.725.000 lekë në favor të Notere A. K. me përshkrimin "kësti i fundit, kontrata rep. *** /kol. ***, datë. ***.

- **ASHK, Drejtoria Tirana Rurale 1**, me shkresën nr. ***prot., datë 31.07.2023, konfirmon pasurinë ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, në pronësi të Thodhori Gravani. Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme "apartament" me sip. 107.1 m², regjistruar me nr. ***, datë 30.03.2017. Në seksionin D përshkruhet bllokimi i pasurisë në favor të Bankës Tirana, për shumën 7.000.000 lekë, sipas kontratës ***, datë 23.05.2017. Në seksionin "E" përshkruhet "verandë" sip. 61.2 m².
 - **FSHU me shkresën nr. *** prot., datë 18.5.2023**, konfirmon se në emër të Thodhori Gravani, identifikohet një abonent në distancën Tiranë, me kontratë nr. TRM110485637324, lëshuar në 17.10.2014.
 - **FSHU me postën elektronike datë 06.10.2023**, konfirmon se përsa i përket nënshkrimit të kontratës në lidhje me abonentin Thodhori Gravani, shtetasi ka paraqitur ankesë/ kërkesë për ndryshim emri, me kalim pronësie, më datë 27.07.2017.
- ✚ Shtetasja Edlira Gravani, nuk ka llogari personale, por është bashkë kredi marrëse dhe ofruese ko laterali për kredinë e shtetasit Thodhori Gravani.

Në proces-verbalin e datës 17.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *“apartamenti në Tiranë ka patur si burim financiar kryesor kredinë bankare dhe vendimi për blerjen e tij është bërë në momentin e finalizimit të kontratës së kredisë”*. Në lidhje me burimin financiar të vjehrrit B.B., sqaroi se *“...të dy bashkëshortët kanë qenë në marrëdhënie pune të pandërprerë dhe gjithashtu vjehrrin, përveç të ardhurave personale, administron edhe të ardhurat e fëmijëve në emigracion dhe konkretisht të djalit, A. B., emigrant mbi 20 vjet në Itali”*

Subjekti sqaroi se për shkak të pamundësisë së likuidimit, kanë nënshkruar një akt të ri noterial, datë 07.07.2023, për zgjatjen e afatit.

Lidhur me shpenzimet e mobilimit, sqaron se kanë qenë në vlerën 900.000 lekë; ka shpenzuar 250.000 lekë në vitin e blerjes 2017, pjesë e të cilave kanë qenë nga tërheqja 800.000 lekë e kryer në Raiffeisen Bank datë 05.12.2017 dhe shuma 350.000 lekë pjesë e shumës 800.000 lekë të tërhequr në datë 07.12.2018 në Raiffeisen Bank, diferenca 300.000 lekë është investuar gjatë viteve 2019 - 2020.

Subjekti paraqiti:

- **Prova mbi mundësitë ekonomike të shtetasit B. B.** mbi dhënien hua shumën prej 2.000.000 lekë, huamarrësit Thodhori Gravani:
- **Vërtetim nga BKT nr. ***, datë 15.11.2019**, për shtetasin B.B., i cili zotëron depozitë me vlerë 41.079 euro, gjendje në datën e lëshimit të vërtetimit. Data e çeljes së llogarisë është 30.11.2010. Bashkëlidhur ndodhen lëvizjet e llogarisë gjatë periudhës 30.11.2010-14.11.2019.
- **Dosjet e përlllogaritjes së pensionit nga ISSH** për D. B., në të cilën evidentohen marrëdhëniet e saj të punësimit gjatë periudhës 15.12.1971 - 31.07.2011 si dhe për B.B., i cili ka qenë në raporte pune për periudhën 17.07.1957- 05.03.2000.
- **Vërtetimet vjetore të ardhurave** të realizuara nga shtetasi A. B. Në shtetin italian, gjatë periudhës 2007 - 2014. Shuma bruto rreth 172.000 euro.
- **Deklaratë noteriale** datë 07.07.2023 e shtetasit B.B., i cili deklaron se ka lidhur një kontratë huaje nr. rep. ***, nr. kol. ***, datë 09.03.2017, me palë huamarrës shtetasin

Thodhori Gravani. Huadhënësi deklaroi se është dakord që të shtyhet afati i kontratës dhe kjo shumë të kthehet për një afat kohe të pacaktuar.

Në proces-verbalin e datës 27.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se, *“...nuk ka pasur ndonjë kontratë paraprake sipërmarrjeje për këtë apartament, por ishte dakordësuar që do të realizonte blerjen vetëm në rast se do t'i jepej mundësia të siguronte një kredi bankare, e cila i është miratuar në mars 2017. Në këto kushte negocioi blerjen e këtij apartamenti”*:

- *Lidhur me verandën me sip. 61.2 m², sqaron se në deklaram gjithmonë i është referuar sipërfaqes sipas certifikatës së pronësisë, ku kjo sip. nuk figuron, por në kontratën e shitblerjes tek rubrika objekti është e pasqyruar dhe ai këtë kontratë e ka bashkëlidhur deklaratës së vlerësimit kalimtar.*
- *Për sa i përket vlerës së blerjes së apartamentit dhe referencës së zonës, subjekti paraqiti tabelën që shoqëron VKM, ku evidenton se në atë kohë referenca ishte 66.500 lekë për m², ndërsa për verandat dhe sipërfaqe ballkonesh përllogaritej 1/2 e vlerës.*
- *Lidhur me vendbanimin e tij, gjatë periudhës që ka punuar në Tiranë deri në blerjen e apartamentit, vitin 2017, sqaron se ka udhëtuar vazhdimisht drejt Vlorës (vajtje-ardhje) dhe në ditë të caktuara ka qëndruar në shtëpinë e një të afërmi të tij (daja). Vetëm për një periudhë të shkurtër ka banuar me qira (janar - qershor 2017) dhe për këtë arsye nuk disponon dokumentacion), vlera mujore e paguar rreth 30.000 lekë. Rezulton se subjekti gjatë periudhës janar - qershor 2017 ka jetuar me qira në Tiranë, deri në blerjen e apartamentit me shpenzime në total rreth 180.000 lekë.*

Subjekti paraqiti:

- **Tabelë shoqëruese e VKM**, për njësitë administrative të Bashkisë Tiranë (nën vijëzuar nga subjekti Njësia nr. 15 Zona Farkë). Kontratë e ngjashme, nënshkruar për një apartament në të njëjtin objekt me atë ku banon subjekti.
- **Kontratë e blerjes** së apartamentit nga V. J. (daja) nënshkruar me Entin e Banesave në vijim

Në proces-verbalin e datës 2.10.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti deklaroi se *“...pavarësisht faktit se në periudhën kur ka marrë hua nga vjehërri, ai dispononte depozitë kursimi, veprimet e huamarrjes janë shlyer në kuadrin e raporteve familjare dhe brenda vullnetit të secilit prej tyre. Vërtetimet e paraqitura (lëvizjet bankare) pasqyrojnë një pjesë të ardhurave që vjehërri dispononte në atë kohë, por përveç këtyre fondeve kishte në dispozicion edhe të ardhura në formë cash”*.

Lidhur me konfirmimin e FSHU, subjekti deklaroi se *“...kontrata e furnizimit me energji elektrike për apartamentin në Tiranë është nënshkruar prej tij në vitin 2017”*.

Konkluzion:

- ✓ Apartamenti me sip. 107.1 m² + verandë me sip. 61.2 m², në Tiranë, në zotërim 100% të subjektit deklarues është përfituar me kontratë blerje viti 2017, në vlerën 10.689.000 lekë, me burim kredi bankare 7.000.000 lekë, hua 2.000.000 lekë dhe kursime personale rreth 1.600.000 lekë. Vlera e apartamentit është likuiduar me bankë.

- ✓ Rezultojnë shpenzime mobilimi për apartamentin në Tiranë, rreth 900.000 lekë, viti 2017-2020. Gjatë periudhës janar - qershor 2017, rezultojnë shpenzime për qira banimi, rreth 180.000 lekë.

Pasuria nr. 3

- Garazh në Selitë, Tiranë, sip. 20 m², viti 2017. Vlera 500.000 lekë. Pjesë takuese 100%.

Burimi i krijimit: nga kursimet familjare.

Bashkëlidhur deklaratës.

- **Kontratë shitblerje** pronë e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol, datë 10.3.2017, nënshkruar ndërmjet palës shitëse shoqëria "Xheluks Konstruksion" ShPK dhe palës blerëse Thodhori Gravani, të një garazhi me sip. 20 m², regjistrin me nr. ***, ndodhur në Selitë, Tiranë çmimi i shitjes në vlerën 500.000 lekë, është shlyer midis palëve, jashtë zyrës noteriale.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **ASHK, Drejtoria Tirana Rurale 1**, me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023, konfirmon pasurinë ***, vol. ***, fq. ***, zk ***, në pronësi të Thodhori Gravani. Bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme "apartament" me sip. 20 m², regjistruar me nr. ***.
- **Në deklaratën para Fillimi të Detyrës 2015**, subjekti nuk deklaroi pasurinë garazh.

Në proces-verbalin e datës 17.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *"për këtë aset është nënshkruar një akt marrëveshje datë 20.07.2012, duke parapaguar shumën 500.000 lekë. Kjo shumë do të shërbente për shlyerjen e vlerës së dakordësuar të garazhit, në momentin që do kryhej kontrata e shitblerjes. Ndërsa për banesën u dakordësuan që do kryenin veprime vetëm n.q.s., do të kishte mundësi financimi. Shuma 500.000 lekë është siguruar nga të ardhurat e kursyera, të cilat i dispononte në ato kohë".* Gjithashtu sqaroi se *"...kontratat e lidhura për të njëjtin aset (garazh) konkretisht, kontrata nr. *** rep., datë 10.03.2017 është kontratë e mirëfilltë shitblerje, referuar nenit 750 e vijues të Kodit Civil, ndërkohë që kontrata e datë 20.07.2012 është një akt marrëveshje e nënshkruar midis palëve jashtë zyrës noteriale, që nuk sjell tjetërsim të pasurisë së paluajtshme, pasi shitblerja e pasurisë së paluajtshme kryhet vetëm me akt noterial, para noterit".*

Subjekti paraqiti:

- **Kontratë** midis palëve datë 20.07.2012, palë shitëse shoqëria ndërtimore "Xheluks Konstruksion" dhe palë blerëse Thodhori Gravani të një garazhi me sip. 20 m², nr. **. Vlera e shitjes së garazhit 500.000 lekë, do të likuidohen sot në datën e nënshkrimit të

kësaj kontrate, sipas mandat arkëtimit. Blerësi do të fitojë pronësinë e garazhit, pas kontratës së shitjes.

- **Mandat arkëtimi** datë 20.07.2012, ku shtetasi Thodhori Gravani ka kryer pranë shoqërisë "Xheluks Construction", likuidimin e shumës 500.000 lekë, për lidhjen e kontratës ndërmjet palëve në datë 20.07.2012, me objekt "garazh" nr. ***.

Në proces-verbalin e datës 27.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti deklaroi se *"...në lidhje me mospërputhjen e nr. e garazhit midis kontratës datë 20.07.2012 dhe kontratës së shitblerjes datë 10.03.2017, ky ndryshim rezulton, pasi për shkak se ishte bërë një pasaktësi nga noteri dhe në momentin që do nënshkruanin kontratën e shitblerjes, rezultoi që garazhi nr. **, i është shitur një banori tjetër dhe në këto kushte u dakortësuan para noterit duke definuar kontratën e shitblerjes së vend parkimit me nr. **, që rezultonte e pashitur në atë kohë"*.

Konkluzion:

- ✓ Garazh me sip. 20 m², në Tiranë është përfituar me kontratë midis palëve në vitin 2012, në vlerën 500.000 lekë, deklaruar me burim nga kursimet familjare. Ai ndodhet në të njëjtin objekt me apartamentin e banimit në Tiranë, i cili është blerë në vitin 2017, pas blerjes së garazhit, fakt për të cilin subjekti ka dhënë shpjegime.
- ✓ Pala shitëse shoqëria "Xheluks" SHPK ka të njëjtin përfaqësues (J. M.) me shoqërinë "Rinia-04" me të cilën është nënshkruar blerja e apartamentit. Subjekti dokumentoi marrëveshjen e shitblerjes së garazhit dhe vlerën e tij.

Pasuria nr. 4

- Llogari në Tirana Bank, me vlerë 49.294 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i të ardhurave: Shitja e apartamentit 56 m², në Sarandë (blerë në vitin 2010, shitur në vitin 2017), me të ardhurat **nga mbyllja e aktivitetit privat/biznesit familjar**. Çmimi i Shitjes 3.000.000 lekë. Këto të ardhura kanë shërbyer për amortizimin e kredisë. Balanca 31.12.2022.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Kontratë** shitblerje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.11.2017, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Thodhori Gravani, jep pëlqimin bashkëshortja Edlira Gravani dhe palës blerëse H.T., të një apartamenti me sip. 56 m², ndodhur në Sarandë, Rruga "Gjergj Araniti", regjistruar me nr. pasurie ***, ZK ***. Çmimi i shitjes në vlerën 3.000.000 lekë, do të likuidohet nga blerësi në llogarinë bankare të noterë E. K. dhe kjo shumë do të mbahet në këtë llogari deri në regjistrimin e pronës në ZVRPP Sarandë në emër të blerësit. Me paraqitjen e dokumentit të pronësisë së regjistruar në emër të blerësit, shitësit bien dakord që noterja duhet të bëjë kalimin e çmimit të shitjes në llogarinë në emër të Thodhori Gravani.
- **Kontratë** shitblerje e pasurisë së paluajtshme nr.*** rep., nr. *** kol., datë 23.08.2010, nënshkruar ndërmjet palës shitëse shoqëria "Tulo" ShPK dhe palës blerëse Thodhori Gravani, të një apartamenti me sip. 56 m², ndodhur në Sarandë pjesa e sipërme e qytetit,

parcela nr. **, regjistruar me nr. pasurie ***, ZK ***. Çmimi i shitjes në vlerën 2.520.000 lekë, është shlyer nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale.

- **Trupa e vlerësimit** për një proces sa me transparent dhe të rregullt, në përputhje me nenin 32-34 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, zhvilloj hetim kryesisht dhe të thelluar mbi pasurinë :
- ❖ Apartament me sip. 56 m², Sarandë, regjistruar me nr. ***, në emër të Thodhori Gravani blerë në vitin 2010.

Në lidhje me pasurinë apartament banimi 56 m² blerë në vitin 2010 dhe shitur në vitin 2017. Trupa e vlerësimit konstaton se, subjekti i vlerësimit nuk i është përmbajtur detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin ** të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke mos e deklaruar pasurinë në rubrikën përkatëse në përputhje me detyrimin e përcaktuar në nenin 32 pika 1. Megjithatë trupa e vlerësimit vlerëson faktin që subjekti i vlerësimit ka deklaruar llogarinë e sipërpërmendur nga ku del edhe fakti i deklarimit mbi këtë pasuri.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, në proces-verbalet datë 17.07.2023 dhe datë 27.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *“...për këtë apartament ka deklaruar se është përfituar nga të ardhurat dhe nga përmbyllja e aktivitetit privat. Në vitet 2004 - 2006 ka ushtruar aktivitetin me NIPT K56612221B me objekt veprimtarie "Tregti me pakicë konfeksione". Aktiviteti ishte biznes i vogël dhe i nënshtrohet Ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, "Për tatimin mbi biznesin vogël." Për shkak të rifillimit të punës në strukturat e Policisë, në vitin 2006 e ka transferuar aktivitetin tek një e afërmja e tij, M.B.me NIPT K664172031A, e cila dhe ka paguar të gjithë detyrimet tatimore për këtë periudhë.”*

Trupa e vlerësimit referuar deklarimit të mësipërm të subjektit të vlerësimit zhvilloj një hetim të hollësishëm mbi burimin dhe mundësinë e krijimit të kësaj pasurie në vitin 2010, të bazuar në prova dhe faktet e dorëzuara nga subjekti i vlerësimit, si dhe duke marrë korrespondence më institucionet ligj zbatuese në vend dhe bankat e nivelit të dytë nga ku me konkretisht:

- ✚ **ASHK, Drejtoria Vendore Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.07.2023**, nuk e konfirmon pasurinë në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.
- ✚ **Tirana Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023**, konfirmon llogarinë në emër të shtetasit Thodhori Gravani dhe gjendjen në datë 09.03.2023, në vlerën 149.460 lekë. Bashkëlidhur ndodhen lëvizjet e llogarisë në të cilën evidentohet se vlera e deklaruar nga subjekti 49.294 lekë, i referohet gjendjes së llogarisë, në datë 27.12.2022. Gjithashtu, evidentohet se në datë 13.12.2017, është kredituar shuma 3.000.000 lekë nga noterë E. K., me përshkrim “kalim sipas kontratës nr. *** rep. nr. *** kol., datë 06.11.2017. Në datë 07.12.2018, transferohet shuma 1.500.000 lekë për pagesë principali të kredisë me përshkrimin "shlyerje pjesore e kredisë, sipas kërkesës së klientit". Diferenca 1.500.000 lekë ka shërbyer për shlyerjet e kësteve mujore të kredisë bankare dhe është debituar periodikisht për këtë qëllim.

✚ **Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023**, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Thodhori Gravani, në të cilën evidentohet se për periudhën: **janar 2006 - janar 2008**, subjekti akumulon fonde nga kreditimi i pagave dhe në 11.01.2008 investon shumën 1.000.000 lekë në depozitë; **janar 2008 - janar 2009** subjekti akumulon fonde nga kreditimi i pagave dhe në 28.01.2009 investon shumën 447.100 lekë në depozitën ekzistuese (**total depozita datë 28.01.2009, vlerë 1.500.000 lekë**); për periudhën **janar 2009 - shkurt 2010**, subjekti akumulon fonde nga kreditimi i pagave dhe në 11.2.2010 investon shumën 417.600 lekë në depozitën ekzistuese (total depozita datë 11.2.2010, vlerë 2.000.000 lekë). Në datë 11.08.2010 depozita e maturuar 2.043.737 lekë, tërhiqet pjesërisht cash 1.043.000 lekë, dhe shuma 1.000.000 lekë rinvestohet në depozitë me afat (trajtohet në vijim). Datë 24.03.2014, shuma 1.000.000 lekë transferohet si investim në Raiffeisen Prestigj. Datë 30.11.2017, shuma 1.199.167 lekë, shlyhen fondet nga Raiffeisen Prestigj.

✚ **Raiffeisen Invest, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023**, konfirmon se shtetasi Thodhori Gravani ka investuar në Fondin Raiffeisen Prestigj, për periudhën 24.03.2014 - 23.11.2017. Bashkëlidhur nxjerrja e llogarisë së investimit fillestar me vlerë 1.000.000 lekë, datë 24.03.2014, si dhe shlyerja e investimit në vlerën 1.199.000 lekë.

✚ **Intesa San Paolo Bank, me postën elektronike datë 18.9.2023**, konfirmon se shtetasja Edlira B., ka qenë kliente e bankës. Bashkëlidhur nxjerrja e llogarisë në të cilën evidentohen: **depozitime cash datë 31.08.2006**, shuma 300.000 lekë; **datë 24.01.2007**, shuma 300.000 lekë, **datë 28.02.2007**, shuma 100.000 lekë; **datë 29.02.2008**, shuma 113.000 lekë; **datë 01.09.2008**, Shuma 100.000 lekë; **datë 02.03.2009**, shuma 180.000 lekë; më **datë 29.03.2010** tërhiqet cash shuma 1.347.362 lekë me përshkrimin "për blerje apartamenti".

Në proces-verbalin e datës 02.10.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti deklaroi se *kësti i parë i apartamentit është paguar në Mars në bazë të një marrëveshje që ka patur më shoqërinë, por nuk disponon dokumentacion. Sqaroi se të gjitha veprimet e shit-blejeve të pasurive të paluajtshme i ka si qytetar i thjeshtë, pasi nuk ka qenë subjekt deklarues. Një pjesë e dokumentacionit është ruajtur dhe një pjesë jo.*

Kontrata e shitblerjes nr. * rep**, për blerjen e këtij apartamenti me sip. 56 m², me vlerë 2.520.000 lekë është nënshkruar më datë 23.08.2010 dhe është shlyer në dy këste; mars 2010 dhe gusht 2010, referuar edhe statement-it nga llogaria e tij në RF Bank, ku rezulton tërheqje e shumës 1.000.0000 lekë, datë 11.08.2010 dhe statement nga llogaria e bashkëshortes në Intesa San paolo Bank, ku rezulton tërheqje e shumës 1.347.362 lekë, datë 29.03.2010. **Më datë 23.08.2010 u finalizua kontrata**. Pagesat janë tërhequr cash nga banka dhe janë likuiduar cash tek kompania shitëse. Përveç veprimeve bankare nuk disponon dokumentacion tjetër.

Për apartamentin në Sarandë janë shlyer investime minimale rreth 300.000 lekë në **vitet 2010 - 2011**, një pjesë e të cilave janë mbuluar me një kredi konsumatorë që ka marrë për elektroshtëpiaket. Nuk disponon dokumentacion për shpenzimet e mobilimit.

Në proces-verbalin e datës 17.10.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti deklaroi se vlerat e depozituara në llogarinë e bashkëshortes në ISP Bank, janë përfituar me burim nga aktiviteti i zhvilluar në emër të M.B.

Subjekti paraqiti:

- **Deklaratë** noteriale nr. *** rep. kol. *** kol., datë 13.10.2023, e shtetases M.B., e cila konfirmon se gjatë viteve **2006 - 2009** ka ushtruar aktivitet privat në fushën e tregtimit me pakicë konfeksioneve, regjistruar me NIPT K664172031A. Si kapital i këtij aktiviteti **ka shërbyer transferimi i aktivitetit** (pajisje, aksesori furnizimi dhe stoku), me të njëjtën veprimtari që ushtronte më parë kunati i saj Thodhori Gravani në vitin 2004. **Pas transferimit të aktivitetit dhe administrimit prej saj, të ardhurat i ka ndarë me motrën e saj Edlira Gravani, ku kjo e fundit ka përfituar vlerën rreth 1.500.000 lekë, të cilat janë përfituar periodikisht sipas bilancit të aktivitetit.**
- ❖ Referuar shkresës së DRT, Vlorë nr. 6928/1, datë 23.7.2014, nga verifikimi në *sistemin C@TS*, nuk ka informacion lidhur me qarkullimin dhe fitimin. Në mungesë informacioni është verifikuar dosja fizike e subjektit, nga ku rezulton se e për vitin fiskal 2004 subjekti ka deklaruar qarkullim në vlerën 2.000.000 lekë dhe për vitin fiskal 2005 ka deklaruar qarkullim në vlerën 1.700.000 lekë. Detyrimet tatimore janë shlyer totalisht për çdo vit fiskal.
- ❖ Subjekti i vlerësimit z. Thodhori Gravani në **pyetjet e dërguara nga Trupa e Vlerësimit** në lidhje me normat e fitimit ka deklaruar se marshi i fitimi për aktivitetin ishte në nivelin 45-50%, por për shkak të kohës të gjatë nuk ka të ruajtura regjistra kontabël apo evidenca të tjera, referuar edhe Ligjit nr. 9477, datë 09.02.2006 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Subjekti paraqiti:

- **Certifikate** për vërtetim pronësie të pasurisë apartament me sip. 56 m², pranë ZVRPP Sarandë, regjistruar me nr. ***, në emër të Thodhori Gravani, datë 01.11.2017. Certificate për vërtetim pronësie të pasurisë apartament me sip. 56 m², pranë ZVRPP Sarandë, regjistruar me nr. ***, në emër të H.T., datë 23.11.2017. Lëvizjet e llogarisë në emër të Edlira Gravani pranë Intesa San Paolo Bank, për periudhën 31.08.2006 - 03.04.2018.
- **Kërkesë** datë 31.10.2017, pranë ASHK Sarandë nga Thodhori Gravani, për lëshim kopje të hartës kadastrale, kartelës së pasurisë; certifikatës së pronësisë.
- **Kërkesë** datë 16.11.2017, pranë ASHK Sarandë nga H.T., për lëshim kopje të hartës kadastrale, kartelës së pasurisë; certifikatës së pronësisë dhe regjistrim të kontratës së shitjes.
- Trupa e vlerësimit referuar të dhënave të mësipërme në lidhje me deklaratimet e subjektit për transferimin e biznesit tek një e afërmja e tij, M.B.me NIPT K664172031A, vlerëson se subjekti këtë deklaram nuk e mbështet në prova konkrete përveç dokumentit “Deklaratë noteriale” nr. *** rep.kol. ***, datë 13.10.2023, e shtetases M.B., e cila “...konfirmon se gjatë viteve 2006 - 2009 ka ushtruar aktivitet privat në fushën e

konfeksioneve, regjistruar me NIPT K664172031A dhe të ardhurat e këtij aktiviteti i ka ndarë me motrën e saj Edlira Gravani, ku kjo e fundit ka përfitur vlerën rreth 1.500.000 lekë, të cilat janë përfitur periodikisht sipas bilancit të aktivitetit...”.

- ✚ **DRT, Vlorë** konfirmon se, në lidhje me aktivitetin e znj. M. B. ekzistojnë të dhëna **vetëm për vitin 2006** ndaj këtij subjekti tregtar, ndërsa për vitet 2007-2009 që subjekti pretendon nuk vërtetohet jo vetëm me dokumentacion e administruar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve por edhe nga dokumentacioni justifikues i subjektit i cili nuk ka paraqitur asnjë provë në lidhje për sa ai pretendon.

Nga verifikimi i shkresave **DRT, Vlorë**, rezulton se subjekti ka ushtruar aktivitetet vetëm në vitin 2006 për të cilat ka vetë deklaruar qarkullim prej **2.600.000**.

Trupa e vlerësimit konstaton se mbetet i pa qartë pretendimi i subjektit mbi vlerën, 1.500.000 lekë dhe mbi mënyrën sesi është llogaritur kjo shumë, duke vlerësuar faktin që aktivitet tregtar, ka ushtruar veprimtari vetëm në vitin 2006.

Konstatimi i subjektit të vlerësimit mbi ushtrimin e aktivitetit të personit fizik, M.B., e cila sipas legjislacionit tatimor dhe konkretisht kreut III A, Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 3, datë 27.01.2003 të Ministrit të Financave, mbështetet vetëm në **të dhëna për qarkullimin e parashikuar për vitin vijues** (sipas pikës 2.1 të Udhëzimit). *(trajtohet më poshtë)*

- Në lidhje me transferimin e aktivitetit nga subjekti i vlerësimit të shtetasja M. B., **Trupa e Vlerësimit** referuar deklaramentit të subjektit të vlerësimit në lidhje me transferimin e aktivitetit “person fizik” dhe referuar legjislacionit tatimor konstaton se në asnjë ligj në legjislacionin tatimor nuk parashikohet kalimi i aktivitetit të personit fizik biznes i vogël nga një subjekt të tjetri, aq më tepër e pa normuar në një kontratë sipas parashikimeve të Kodit Civil.

Në lidhje me konstatimet e trupës së vlerësimit, me emalin e datës **12.01.2024**, “Disa sqarime ne lidhje me relacionin paraprak”, z. Thodhori Gravani, sqaron se “...Në fakt definicionin e transferimit të aktivitetit nga pikëpamja fiskale për subjektet tregtare pavarësisht nga statusi i tyre (fizik ose juridik) e trajton ligji Nr. 7928, datë 27.4.1995 ”Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar , neni 12 i tij, por edhe Udhëzimi MF Nr.17 Datë 13.05.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar...” ku ndër të tjera citon nenin 12 të ligjit ligji nr. 7928, datë 27.4.1995 “Nëse një person i tatueshëm i kalon të gjithë veprimtarinë ose një pjesë të saj një personi tjetër, i cili është ose bëhet i tatueshëm në lidhje me veprimtarinë e kaluar, duke e vazhduar atë dhe ky transaksion plotëson njëkohësisht kushtin ekonomik dhe ligjor, kalimi konsiderohet transferim i veprimtarisë ekonomike dhe nuk është i tatueshëm....”.

- 1. Trupa e vlerësimit** referuar të njëjtës referencës të cituar më sipër nga subjekti i vlerësimit, **vë në dukje të njëjtin qëndrim të mbajtur nga trupa e vlerësimit**, pasi legjislacioni i referuar nga subjekti i vlerësimit, megjithëse për analogji parashikon se “...midis dy personave duhet të jetë përpiluar gjithashtu një kontratë transferimi e noterizuar, mbështetur në Kodin Civil...”.

- 2. Trupa e vlerësimit referuar pretendimeve të subjektit të vlerësimit mbi pretendimin për përfitimin e realizuar nga aktiviteti privat për vitin 2004 - 2005** në lidhje me fitimin e realizuar, kreu një hetim të thelluar të mbështetur në legjislacionin e kohës, konkretisht ligjin nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël” të ndryshuar me ligjin nr. 9327, datë 06.12.2004, ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzim Nr. 2 të Ministrit të Financave, datë 10.04.2003 “Për Procedurat Tatimore”, Udhëzim nr.3 të Ministrit të Financave, datë 11.02.2002 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, Udhëzim nr. 3 datë 27.01.2003 “Për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin”, etj.;

Konkretisht:

1. Për periudhën 01.01.2004 – 31.12.2004

Nga materialet shkresore të grumbulluara rezulton se gjatë vitit 2004 subjekti i vlerësimit ka aplikuar për **regjistrimin për herë të parë** mbështetur në pikën 2.1 të Udhëzimit Nr. 3, Datë 27.01.2003 të Ministrit të Financave, **duke parashikuar qarkullimin për vitin vijues.**

Referuar ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, subjektet të cilat ushtronin aktivitetin e tregtisë me pakicë në qytetin e Vlorës, kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit në kuotë fikse në shumën **20,000 lekë**, referuar tabelës 1.

Ndërsa, sipas ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është në masën **4% (për qind)** të qarkullimit të realizuar gjithsej nga tatimpaguesi gjatë një viti kalendarik.

Për këtë periudhë tatimore subjekti i nënshtrohet nenit 32/6, pika 1, germa c e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar me ligjin 8979 datë 12.12.2002 i cili thotë se *“në rastin e subjekteve të regjistruara për herë të parë, qarkullimi i vlerësuar është qarkullimi i vlerësuar (parashikuar) i tatimpaguesit për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik të biznesit të tij”*.

- ✚ Nga sa më sipër bazuar në legjislacionin e kohës subjekti i vlerësimit me nipt K56612221B ka parashikuar qarkullim për vitin 2004 në vlerën 2.000.000 lekë.
- ✚ **Kësti i parë deri në 3 muaj nga periudha e regjistrimit:** Shuma 20,000 lekë është përcaktuar si vlera që rezulton nga shumëzimi i qarkullimit **2,000,000 lekë * 4% * 25% = 20,000 lekë**, referuar nenit 32/6 (nënndarja “i”, shkronja “a”, pika 2), të ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.
- ✚ **Kësti i dytë deri në 31 dhjetor 2004:** Shuma 40,000 lekë është përcaktuar si vlera që rezulton nga shumëzimi i qarkullimit 1,000,000 lekë * 4% * 50% = 40,000 lekë, referuar nenit 32/6 (nënndarja “ii”, shkronja “a”, pika 2), të ligjit nr. 8979, datë

12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Në lidhje me deklaratimet e subjektit dhe nga kthim përgjigjet DRT Vlore për këtë periudhë objekt analizimi viti 2004, nuk rezultojnë të jetë depozituar/ administruar dokumentacion, i cili të referojë të dhëna për pagesa detyrimesh të taksave vendore, tatim të thjeshtuar mbi fitimin apo për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, veprime të cilat do të ligjëronin të ardhurat e pretenduara nga subjekti i vlerësimit të përdorura si burim për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 56m².

Për periudhën 01.01.2005 – 31.12.2005.

Deri në Mars 2005, subjekti duhet të dorëzojë një deklaratë ku të tregojë qarkullimi e tij real për vitin 2004 i vlerësuar për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2004 ishte 1.700.000 lekë. Referuar ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël” i ndryshuar me ligjin nr. 9327, datë 06.12.2004, subjektet të cilat ushtronin aktivitetin e tregtisë me pakicë në qytetin e Vlorës, kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit në kuotë fikse në shumën **20,000 lekë** referuar tabelës 1, i cili shtrihet në dy këste pagesash, prill dhe shtator dhe nga ku pagesa totale para shkurtit për vitin fiskal, e ul këtë detyrim me 5% në total.

Ndërsa, sipas ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar me ligjin 9326, datë 06.12.2004, shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është në masën **3% (për qind)** të qarkullimit të realizuar gjithsej nga tatimpaguesi gjatë një viti kalendarik të mëparshëm.

Nga sa më sipër bazuar në legjislacionin e kohës subjekti i vlerësimit me nipt K56612221B **ka deklaruar qarkullim real për vitin 2004 në vlerën 1.700.000 lekë**, i cili merret për bazë në vitin 2005.

Shuma 51,000 lekë është përcaktuar si vlera që rezulton nga shumëzimi i qarkullimit 1,700,000 lekë * 3% = **51,000** lekë, referuar nenit 32/6 (nën ndarja “i”, shkronja “a”, pika 2), të ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar të ligjit nr. 9326, datë 06.12.2004, e cila paguhet jo më vonë se datat 20 prill, 20 korrik dhe 20 tetor, përkatësisht, për tremujorin e parë, të dytë dhe të tretë të vitit ushtrimor dhe jo më vonë se data 20 dhjetor për tremujorin e katërt të vitit ushtrimor.

Për këtë periudhë objekt analizimi, është depozituar/administruar dokumentacion, i cili të referojë të dhëna për pagesa detyrimesh të taksave vendore², këstet prej 17.000 lekë, e tatimeve të thjeshtuara³ korrik, shtator 2005 prej 17.000 lekë, dhjetor prej 13.304 lekë tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe vërtetohet të ketë paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

- **Duke analizuar periudhën e Vitit fiskal 2005**, mandat pagesave të paraqitura nga subjekti i vlerësimit mbi pagesat e taksës vendore, pagesat e kësteve të tatimit të thjeshtuar dhe detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe duke marrë të

² Vërtetohet me mandat arkëtimi në bankë

³ Urdhër pagese nr. Vlerësimi 4152760200 e nr. Serial NIPT K56612221B, Urdhër pagese për TVSH, nr. Vlerësimi 41533901996 e nr. Serial NIPT K56612221B

mirëqenë se subjekti nuk ka deklaruar xhiro më të ulët faktike për vitin 2005, rezulton se subjekti ka realizuar të ardhura 17.000.000 - tatimet e paguara (tatimet vendore dhe tatimin e thjeshtuar), së bashku me sigurimet shoqërorë e shëndetësorë, - qiranë e deklaruar të dyqanit (20.000 lekë/muaj), nuk dihen shpenzime të zbritshëm sa i përket shpenzimeve operative, drita+ ujë etj. dhe duke marrë të mirëqenë deklaratimet e subjektit për një marzhë fitimi prej 45-50% (megjithëse nuk paraqiti prova shkresore si libër shitje, libër blerje, fatura doganore etj. për të provuar deklaratimet e tij) rezulton se subjekti ka realizuar fitime jo më tepër se **700.000 lekë** për **vitin 2005**.

Për subjektin e deklaruar M.B. me NIPT K66414203A, ku subjekti deklaroi se i ka transferuar aktivitetin pasi ka qenë motra e bashkëshortes, Trupa e Vlerësimit nuk e merr në analizë pasi subjekti nuk paraqiti fakte të mbështetura në prova shkresore (kontratë transferimi e noterizuar sipas kodit civil), se i ka transferuar biznesin shtetasës M.B..

Gjithsesi referuar të dhënave të paraqitura nga subjekti i vlerësimit M.B. me NIPT **K66414203A** për periudhën tatimore **Mars 2006** ka paraqitur me 0 (zero) lekë, TAP (tatimi mbi të ardhurat personale) dhe me datë 25.04.2006 ka paraqitur pagesën e sigurimeve shoqërore prej 8.060 lekë.

Trupa e vlerësimit në lidhje me shumën prej 1.500.000 lekë, të pretenduar nga subjekti i vlerësimit që ka kaluar nga shtetasja M. B. në llogarinë e bashkëshortes së tij për periudhat 2006-2010 zhvilloi hetimin e më konkretisht:

- **U administrua dokumentacioni i regjistrimit të aktivitetit** privat në emër të M.B.(certifikate regjistrimi në organin tatimor shkurt 2006; autorizim administrativ nga Inspektorati Shtetëror i Punës; Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Vlorë; Certificate e regjistrimit në organet tatimore vendore; tabelë e llogaritje së taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit për vitin 2006; vendimi i gjykatës për regjistrimin e aktivitetit). Bashkëlidhur ndodhet vërtetimi nr. *** prot., datë 18.7.2019, i DRT Vlorë për M.B.- PF, me veprimtari "tregti me pakicë e veshjeve" e cila është regjistruar në datë 17.02.2006 dhe është në status pasiv.
- Subjekti ka deklaruar qarkullim për vitin 2006, në vlerën 2.600.000 lekë.

Për periudhën 01.01.2006 – 31.12.2006:

Referuar legjislacionit të mësipërm mbi përlllogaritjet e vlerave për realizimin e fitimit nga aktiviteti privat si person fizik, për subjektin M. B. nga trupa e vlerësimit u zhvilluar hetimi administrativ në referim të legjislacionit tatimor ku rezultoi se:

Referuar ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, "Për taksën vendore për biznesin e vogël" i ndryshuar me ligjin nr. 9327, datë 06.12.2004 dhe ndryshuar me ligjin Nr.9432, datë 13.10.2005, subjektet të cilat ushtronin aktivitetin e tregtisë me pakicë në qytetin e Vlorës, kanë pasur detyrimin për pagesën e tatimit në kuotë fikse në shumën **10,000 lekë** referuar tabelës 1 të ndryshuar.

Ndërsa sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar me ligjin Nr.9431, datë 13.10.2005, neni 1 "...shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin

është 1,5 për qind...”, ku rezulton se shtetasja M.B. e lidhur me subjektin e vlerësimit këtë detyrimin për të paguar shumën **39,000 lekë** për vitin tatimor, e cila është përcaktuar si vlera që rezulton nga shumëzimi i qarkullimit 2,600,000 lekë * 1.5% = 39,000 lekë

Në lidhje me deklaratimet e shtetasës M. B., dokumentacioni tatimor mbi këtë subjekt dhe nga kthim përgjigjet DRT Vlore për periudhën objekt analizimi viti 2006, nuk rezultojnë të jetë depozituar/ administruar dokumentacion, i cili të referojë të dhëna për pagesa detyrimesh të taksave vendore, tatim të thjeshtuar mbi fitimin apo për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, veprime të cilat do të ligjëronin të ardhurat e pretenduara nga subjekti i vlerësimit të kaluara për periudhën 2006-2010 në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, të cilat sipas subjektit të vlerësimit kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në qytetin e Sarandës në vitin 2010.

Konstatimi i trupës së vlerësimit:

Trupa e vlerësimit **në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 65m²**, pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i vlerësimit si dhe referuar legjislacionit tatimor në fuqi arrin në konkluzionin se:

1. subjekti i vlerësimit për periudhat 2004 - 2005 nga aktiviteti privat biznes “tregti me pakicë e veshjeve” ka mundur të realizojë të ardhura neto të dokumentuar në vlerën jo më tepër se 700.000 lekë.
2. mbi vlerën prej 1.500.000 lekësh të pretenduara si kalim nga znj. M. B. në llogari të bashkëshortes së subjektit nuk u provua fakti i fitimit të ardhurave nga biznesi.
3. apartamenti me sipërfaqe 56m² është blerë në vlerën 2.520.000 lekë, kjo shumë nuk arrin të provohet si mundësi krijimi nga të ardhurat e biznesit si rrjedhojë konstatohet mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e pasurisë pasi nga dokumentacioni i administruar u vërtetua vetëm shuma prej 700.000 lekë.

Trupa e Vlerësimit në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi në qytetin e Sarandës konstaton se jemi në kushtet e gërmës “b” pikës “6” të nenit 34 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, **mungesë të burimeve ligjore, të ardhura nga biznesi, për krijimin e pasurisë.**

Gjatë seancës dëgjimore të datës 26.01.2024, në fjalën e tij subjekti i vlerësimit pretendon faktin se si burim pasurisë së sipërcituar me sipërfaqe 56 m² në qytetin e Sarandës kanë shërbyer të ardhurat nga paga e tij dhe të bashkëshortes ndër vite.

Ndërkohë që në deklaratën e pasurisë dhe gjatë hetimit administrative ka pohuar dhe ka pasqyruar dokumentacion që të mbështesë faktin se burimi i krijimit të kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat e përfituara nga mbyllja e biznesit me Nipt K56612221B.

Trupa e vlerësimit për të shteruar çdo paqartësi apo pretendim të dalë gjatë hetimit administrativ nga subjekti i vlerësimit, mori në analizë të ardhurat e realizuara nga paga e subjektit dhe bashkëshortes së tij nga bankat e nivelit të dytë konstatohet se:

- ✚ për periudhën: **janar 2006 - janar 2008**, subjekti akumulon fonde nga kreditimi i pagave dhe në 11.01.2008 investon shumën 1.000.000 lekë në depozitë; **janar 2008 - janar 2009** subjekti akumulon fonde nga kreditimi i pagave dhe në 28.01.2009 investon shumën

447.100 lekë në depozitën ekzistuese (**total depozita datë 28.01.2009, vlerë 1.500.000 lekë**); për periudhën **janar 2009 - shkurt 2010**, subjekti akumulon fonde nga kreditimi i pagave dhe në 11.2.2010 investon shumën 417.600 lekë në depozitën ekzistuese (total depozita datë 11.2.2010, vlerë (2.000.000 lekë)). Në datë 11.08.2010 depozita e maturuar 2.043.737 lekë, tërhiqet pjesërisht cash 1.043.000 lekë, dhe shuma 1.000.000 lekë rinvestohet në depozitë me afat (trajtohet në vijim). Datë 24.03.2014, shuma 1.000.000 lekë transferohet si investim në Raiffeisen Prestigj. Datë 30.11.2017, shuma 1.199.167 lekë, shlyhen fondet nga Raiffeisen Prestigj.

Gjithashtu gjatë seancës dëgjimore, subjekti i vlerësimit nuk arriti të qartësojë dhe të bindë trupën vlerësuese për dinamikën e akumulimit të fondeve, nga kreditimi i pagave nga viti 2006 deri në vitin 2010, **sidomos gjatë periudhës janar 2006 - janar 2008, ku shuma e pagave të akumuluar në total, është shuma reale e pagës së përfituar për dy vite nga puna e tij.**

Trupa vlerësuese arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe të qartësojë mënyrën e jetesës së familjes së tij gjatë viteve 2006-2008, vetëm me pagën e bashkëshortes. Për rrjedhojë sqarimet e tij mbetën në nivelin e pretendimeve të paprovuara.

Referuar të dhënave të INSTAT për shpenzimet jetike trupa e vlerësimit ka konstatuar se subjekti i vlerësimit **nuk ka pasur mundësi për krijimin e depozitës prej 2.000.000 lekësh në vitin 2010**. Për me tepër theksohet fakti që subjekti i vlerësimit ka tërhequr nga depozita e maturuar, në datën 11.08.2010 vlerën prej 1.000.000 lekë dhe ka ridepozituar vlerën e mbetur, prej 1.000.000 lekë, të tjera në depozitë me afat. Të cilat rezultojnë gjendje në llogari në momentin e blerjes së apartamentit.

Referuar të dhënave për të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes konstatohet se ato janë të pamjaftueshme për të krijuar vlerën totale të blerjes së pasurisë, nga pagat sipas pretendimit të subjektit të vlerësimit.

Në zbatim të nenit 34 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, trupa e vlerësimit referuar të dhënave të faktit konstaton **pamjaftueshmëri të ardhurash nga paga për blerjen e pasurisë së subjektit të vlerësimit dhe personit të lidhur me të.**

Trupa e vlerësimit, në lidhje me pretendimin e subjektit të vlerësimit për kalimin e aktivitetit të znj. M. B. referuar legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar ndër të tjera përcakton **“...midis dy personave duhet të jetë përpiluar gjithashtu një kontratë transferimi e noterizuar, mbështetur në Kodin Civil...”** konstaton mungesën e formës ligjore të nevojshme për vlefshmërinë e këtij kalimi.

Pasuria nr. 5

➤ Llogari në Raiffeisen Bank, me vlerë 2.150.928 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Burimi i të ardhurave: kursimet personale gjatë periudhës së punësimit. Balanca: 31.12.2022.

Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Thodhori Gravani, me gjendje në datë 09.03.2023, vlerën 2.171.504 lekë.

Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në data të ndryshme dhe konkretisht, subjekti deklaroi gjendjen e llogarisë në Raiffeisen Bank datë 31.12.2022, ndërsa konfirmimi i bankës është i datës 09.03.2023.

B. DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- **Të ardhura** nga funksioni Drejtor Drejtorie në Aparatin qendror të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën **janar - dhjetor 2022**. Shuma e të ardhurave.
- **Të ardhura** nga funksioni Drejtor Drejtorie në Aparatin qendror të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën **janar - dhjetor 2021**. Shuma e të ardhurave 1.721.947 lekë.
- **Të ardhura** nga funksioni Drejtor Drejtorie në Aparatin qendror të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën **2018 - 2020**. Shuma e të ardhurave 4.792.019 lekë.
- **Të ardhura** nga funksioni Drejtor Drejtorie në Aparatin qendror të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën **29.5.2015 - 31.3.2018**. Shuma e të ardhurave 3.520.234 lekë.
- **Të ardhura** nga funksioni si Shef Sektori në Drejtorinë e Policisë Vendore Tiranë, për periudhën **31.1.2014 - 29.5.2015**. Shuma e të ardhurave 1.639.500 lekë.
- **Të ardhura** nga funksioni si Shef Sektori në Drejtorinë e Policisë Vendore Vlorë për periudhën **10.3.2008 - 13.1.2014**. Shuma e të ardhurave 4.427.353 lekë. Të ardhura nga funksioni si Shef Sektori në Drejtorinë e Policisë Vendore Fier për periudhën 7.12.2005 - 10.3.2008. Shuma e të ardhurave **1.402.713 lekë**.
- Të ardhura nga funksioni si Shef Sektori në Drejtorinë e Policisë Vendore Vlorë për periudhën 31.10.1997 - 13.1.2004. Shuma e të ardhurave **3.194.653 lekë**.
- **Të ardhura** nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, viti 2004. Shuma e të ardhurave 648.000 lekë.
- **Të ardhura** nga aktiviteti i **biznesit familjar (vitet 2004 - 2007)** dhe **licenca si Ekspert Vlerësim Pasurie (2010 - 2014)**. Vlera 3.000.000 lekë.
- **Të ardhura** nga emigracioni (1993 - 1994 - 1995); aktiviteti privat (1995 - 1996 - 1997); interesa, kontrata huaje, firma rentiere (1996 - 1997). Shuma e të ardhurave 4.000.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për Thodhori Gravani, i cili është punonjës i këtij institucioni dhe për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021 ka realizuar të ardhura në shumën totale neto prej 1.721.947 lekë (vlera përmban të ardhura nga paga, uniforma, shpërblime, leje e zakonshme).
- Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për Thodhori Gravani, i cili është punonjës i këtij institucioni dhe për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2020 ka

realizuar të ardhura në shumën totale neto prej 4.792.019 lekë (vlera përmban të ardhura nga paga, uniforma, shpërblime, leje e zakonshme).

- Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nr. *** prot., datë 12.4.2018 për Thodhori Gravani, i cili për periudhën 29.5.2015 - 31.4.2018 ka realizuar të ardhura në shumën totale neto prej 3.520.234 lekë (vlera përmban të ardhura nga paga, uniforma, shpërblime, leje e zakonshme).
- Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nr. *** prot., datë 16.04.2018, për Thodhori Gravani, i cili për periudhën 13.01.2014 - 28.05.2015 ka realizuar të ardhura në shumën totale neto prej 1.600.395 lekë (vlera përmban të ardhura nga paga, uniforma, shpërblime, leje e zakonshme).
- Vërtetim nr. *** prot., datë 12.4.2018, nga Drejtoria e Policisë Fier për Thodhori Gravani, i cili për periudhën 07.12.2005 - 12.8.2008 ka realizuar të ardhura në shumën totale neto prej 1.402.713 lekë (vlera përmban të ardhura nga paga, uniforma, shpërblime, leje e zakonshme).
- Vërtetim nga Drejtoria e Policisë Vlorë, për Thodhori Gravani, që konfirmon se për periudhën 01.11.1997 - 16.12.2005; 13.3.2008 - 12.01.2014 ka realizuar të ardhura nga paga. Për periudhën 01.11.1997 - 30.11.2005, të ardhurat neto janë gjithsej rreth 2.618.000 lekë.
- Vërtetim nga Drejtoria e Policisë Vlorë, për Thodhori Gravani, i cili për periudhën 1997 - 2002 ka realizuar të ardhura për shpërblime dhe taksë solidariteti në shumën totale neto prej 555.797 lekë.
- Vendim nr. ***, datë 25.5.2004 e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, duke caktuar detyrimin e palës së paditur Ministria e Rendit Publik, të paguaj në favor të paditësit Thodhori Gravani, shumën prej 648.000 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot. datë 2.5.2018 nga DRT Vlorë, për Thodhori Gravani me NIPT K56612221B, aktiviteti "tregti me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara' është regjistruar pranë këtij institucioni në datë 13.01.1995, me Vendim Gjykatë me Shkresë "Për përgjigje nr. pro ***, datë 23.07.2019, nga DRT Vlorë për Thodhori Gravani, i regjistruar me kod fiskal ***, si person fizik, rezulton se ka patur ngarkesë tatimore në shumën 55.002 lekë, vetëm për vitin 1998.
- Kontratë qiraje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.10.2004, nënshkruar ndërmjet palës qiradhënëse V. B. dhe palës qiramarrëse Thodhori Gravani, të një dyqani që ndodhet në lagjen "Pavarësia" Vlorë. Vlëra e qirasë 20.000 lekë/muaj. Afati 18 muaj.
- Tabela e llogaritjes së taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit në subjektin e biznesit të vogël për vitin 2005.
- Tabela përlllogaritëse e taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit për vitin 2005, Thodhori Gravani Nipt K56612221B.
- Certificate e regjistrimit në organet tatimore vendore, Viti 2006. Autorizim administrativ (Viti 2005) për subjekti Thodhori Gravani nga Drejtoria e Inspektoratit të Punës Vlorë.
- Tabelë përmbledhëse e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Vlorë, lëshuar për Thodhori Gravani, lloj aktiviteti "konfeksione ", rruga "S. Zotaj", Vlorë.
- Certificate regjistrimi pranë QKB, datë 24.06.2010, Thodhori Gravani - Person Fizik, me NIPT L06824209V
- Vërtetim aplikim çregjistrimi pranë QKB, datë 16.02.2016, Thodhori Gravani - Person Fizik, me NIPT L06824209V

- Mandate arkëtimi në BKT, Thodhori Gravani paguan në favor të Zyrës së Tatim Taksave shumë 9.167 lekë. Periudha shkurt, mars, maj, tetor, nëntor 1995.
- Tabela përlllogaritëse e taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit, për vitin 2006, M. B. Nipt K66417203A, xhiro e parashikuar 2.600.000 lekë.
- Certifikate e regjistrimit në organet tatimore vendore, lëshuar nga Bashkia Vlorë, për M.B. Viti 2006.
- Kontratë huaje nënshkruar në datë 27.10.1996, para avokates Jeta Hasani, nga shtetasi Thodhori Gravani, në cilësinë e palës huadhënëse dhe F. K., president i "Kamberi" Co, në cilësinë e palës huamarrëse. Huadhënësi i jep hua "Kamberi" Co, shumë 2.700.000 Drahmi dhe 4.000 Usd, për një afat prej 6 muaj deri në dt. 27.04.1997, me interes 10% i cili do të shlyhet çdo 3 muaj. Bashkë lidhur: mandat arkëtimi nr. 451, datë 12.11.1996, shuma 1.700.000 Drahmi dhe 4.000 Usd.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **Në deklaratën Periodike Vjetore FLI 2021, subjekti deklaron të ardhura nga qira banese për periudhën 19.07.2021 - 31.12.2021, në vlerën 150.000 lekë, sipas kontratës së qirasë nr. 1311 rep., nr. 411 kol., datë 19.07.2021.**
- **Raiffeisen Bank** me shkresën nr. *** prot., datë 08.02.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Thodhori Gravani, në të cilën janë kredituar paga gjatë periudhës dhjetor 2005 - mars 2023, në shumë totale rreth 19.500.000 lekë.
- **QKB** me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se shtetasi Thodhori Gravani figuron i regjistruar:
- **Person Fizik** nga data 24.06.2010, me NIPT L06824209V. Kërkesë për çregjistrim pranë QKB, datë 16.02.2016. Statusi i subjektit: "Çregjistruar". Referuar ekstraktit historik bashkëlidhur, shkresës rezulton se aktiviteti është çregjistruar nga data 31.03.2016. Fusha e veprimtarisë "ekspert vlerësues i pasurive të paluajtshme". Vendi i ushtrimit të aktivitetit: Vlorë, "Lagjja Pavarësia Person Fizik nga data 12.04.2005, me NIPT K56612221B. Statusi i subjektit "aktiv". Referuar ekstraktit historik bashkëlidhur shkresës rezulton se fusha e veprimtarisë së këtij aktiviteti është "tregtia me pakicë e veshjeve" Vendi i ushtrimit të aktivitetit: Vlorë, Lagjja Pavarësia .
- **DPT me shkresën nr. ***, datë 12.05.2023**, konfirmon se shtetasi Thodhori Gravani, rezulton i regjistruar pranë DRT, Vlorë, si administrator në shoqërinë "**Euro-Al-Grup**" ShPK., me Nipt **K06924209A**, prej datës **09.10.2000**.
- **ISSH me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023**, konfirmon periudha kontributeve të Thodhori Gravani janar 2012 - mars 2023, pranë Drejtorisë së Policisë Vlorë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
- **DRT Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023**, konfirmon se shtetasi Thodhori Gravani, figuron i regjistruar si tatimpagues Person Fizik, me NIPT L06824209V, prej datës 24.06.2010. Gjatë viteve të ushtrimit të aktivitetit, subjekti nuk ka deklarata tatimore të dorëzuara, xhiro/fitim apo dividend. Është çregjistruar përfundimisht nga sistemi tatimor më dt. 31.03.2016.
- **DRT Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 05.10.2023**, konfirmon se nga verifikimi i të dhënave në sistemin C@ts, si dhe në arkivin e institucionit, ka rezultuar se ekziston një dosje në arkivë me NIPT K56612221B, në emër të Thodhori Gravani me ditëlindje

24.1.1968. Për shkak të mungesës së të dhënave identifikuese në dosjen e personit (ID dhe atësi) është e pamundur të përcaktohet nëse është i njëjti person.

- **DRT Vlorë, me shkresën elektronike datë 18.10.2023**, konfirmon se nga verifikimi në dosjen fizike të subjektit Thodhori Gravani me NIPT K56612221B, rezulton se për vitin 2005 ka realizuar qarkullim në vlerën 1.700.000 lekë.

Në proces-verbalin e datës 17.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *“...ka ushtruar aktivitetin privat person fizik në kohën që nuk ka qenë në marrëdhënie pune 1995 - 1997 dhe në vitin 2004 - 2005 me NIPT K56612221B, ndërsa në periudhën 2006 - 2009 ja transferoi kunatës, M.B., me NIPT K66414203A, pavarësisht se nuk kishte pengesa ligjore për ushtrim aktiviteti si person fizik. Ka një mospërputhje tek statusi që figuron ende aktiv, pasi ka bërë disa herë kërkesë për ç ‘aktivizim. I është drejtuar DRT Vlorë dhe i është vënë dy herë në dispozicion përgjigje zyrtare, që nuk ka detyrime se është me status “pasiv” që në vitin 2011 dhe me gjasa është një mos rakordomë midis dy sistemeve. Gjatë ushtrimit të detyrës nuk ka patur aktivitet tregtar në emër të tij”*.

Gjithashtu sqaroi se *“...për periudhën 1993, 1994, 1995 ka qenë emigrant në Greqi, ku ka punuar si punëtor në punë të ndryshme së bashku me bashkëshorten. Gjatë këtyre viteve ka kursyer dhe ka sjellë në Shqipëri rreth 5 milion dhrahmi, e konvertuar me kursin e kohës rreth 2.300.000 lekë - 2.500.000 lekë. Në vitin 1995, një pjesë të shumës e ka përdorur për biznesin e tij dhe një pjesë, i ka investuar në firmat rentiere në shumën prej 2.700.000 dhrahmi dhe 4.000 USD, sipas kontratës së huadhënies nr. ***, të datës 27.10.1996. Shumat e dhrahmive nga emigracioni i ka sjellë në formën “cash”, gjatë kohës së hyrje - daljes në Shqipëri”. Në vitin 1995, është rikthyer në Shqipëri dhe ka ushtruar aktivitetin privat në emrin e tij, Thodhori Gravani, me Kod Fiskal 4400465 dhe me NIPT K56612221B, me objekt veprimtarie “Tregti me pakicë konfeksione biznes i vogël”. Referuar ligjit, tatimi për biznesin e vogël llogaritet me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që realizoheshin nga shitja, tarifa që është llogaritur nga administrata tatimore është 3 % në vit. Çdo fillim viti ka tërhequr në DRT Vlorë “Deklaratën e barrës fiskale të cilën e ka paguar periodikisht me këste në zbatim të ligjit të mësipërm.*

*Aktiviteti tregtar që ushtronte kërkonte rinovimin e Certifikatës Tatimore çdo vit nga ana e administratës tatimore, rinovimi i së cilës bëhej vetëm pasi subjekti të kishte shlyer të gjitha detyrimet tatimore të vitit të mëparshëm. Certifikata tatimore shoqërohej me detyrimin mbi taksën për biznesin e vogël, që subjekti do të paguante gjatë vitit ushtrimor të ndarë në këste përkatëse. Për sa më sipër, të ardhurat totale të realizuara nga biznesi familjar ndër vite, janë në vlerën prej **7.000.000 lekë** dhe marshi i fitimit për aktivitetin që ai ushtronte ishte në nivelin **45-50%**. Detyrimet tatimore janë shlyer totalisht për çdo vit fiskal, kjo gjë është sqaruar edhe me përgjigjen zyrtare të DRT Vlorë, me shkresën nr. ***, datë 23.7.2019 dhe nr. **, datë 23.07.2019.*

*Në lidhje me të ardhurat e përfituara si ekspert i vlerësimit të pasurisë për periudhën 2010 - 2016, sqaroi se ka ushtruar aktivitetin me NIPT L06824209V, **duke realizuar të ardhura vetëm për vitin 2010**, kurse për vitet e tjera ka qenë me status pasiv, kjo e vërtetuar dhe me shkresën e DRT Vlorë nr. ***, datë 25.7.2019. Në këto rrethana është vlerësuar nga administrata tatimore vetëm për vitin 2010, me xhiro deri 2.000.000 lekë, në zbatim të detyrimit të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006. Ky lloj aktiviteti realizohej nëpërmjet akt ekspertimeve të ndryshme dhe periudhën në vazhdim, nuk ka deklaruar të ardhura duke mbajtur këtë lloj licence me status pasiv më shumë për CV profesionale.*

Burimi financiar i të ardhurave të investuara në aktivitetin privat dhe në firmat rentiere janë pikërisht të ardhurat nga emigracioni. Investimet janë shlyer menjëherë pas kthimit nga emigracioni. Gjithashtu, fondet e investuara në shoqërinë Kamberi janë tërhequr në Bankën e Kursimeve rreth viteve 2000.

Subjekti paraqiti:

- **Pasaportë personale** e vitit 1991. Vizë nga Konsullata Greke, viti 1993. Deklaratë me përgjegjësi - Autorizim, datë 28.11.2019, nga ish punëdhënësi në Greqi M. M. i cili deklaroi se ka punësuar shtetasin Thodhori Gravani, gjatë viteve 1993 - 1995, në punë të ndryshme ndërtimi në Leivadeia, në mënyrë të vazhdueshme (përkthyer nga gjuha greke dhe noterizuar).
- **Shkresa kthim përgjigje nr. ***, datë 23.07.2019**, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë sipas së cilës: Thodhori Gravani, figuron i regjistruar si Person Fizik me Vendim Gjykatë nr. *** datë 13.01.1995 dhe NIPT K56612221B. Subjekti ka deklaruar qarkullim për vitin 2004 në vlerën 2.000.000 lekë dhe për vitin 2005 në vlerën 1.700.000 lekë. M.B., figuron e regjistruar si Person Fizik, me NIPT K66417203A. Subjekti ka deklaruar qarkullim për vitin 2006, në vlerën 2.600.000 lekë.
- **Vërtetim nga Tatim-Taksat, Vlorë**, nr. *** prot, datë 17.7.2019, për subjektin Thodhori Gravani, i cili figuron i regjistruar si Person Fizik, me Vendim Gjykatë nr. 10096, datë 13.01.1995 dhe NIPT K56612221B, aktivitet "konfeksione" Subjekti ka kaluar në status "Pasiv", në datë 14.06.2011.
- **Vërtetim i aplikimit pranë QKB**, më datë 23.07.2019 "Çregjistrim Person Fizik" Thodhori Gravani, NIPT K56612221B.
- **Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot.**, datë 12.7.2019, nga Drejtoria e Hetimit Tatimor pranë DPT, në të cilën vërtetohet se për shtetasin Thodhori Gravani, rezultoi të ketë qenë administrator pranë subjektit "Thodhori Gravani", me NIPT L06824209V, i cili ka kaluar me status "Çregjistruar" prej datës 31.3.2016. Gjithashtu rezultoi të ketë qenë administrator pranë subjektit "Thodhori Gravani me NIPTK56612221B, i cili ka kaluar me status "Çregjistruar" prej datës 14.6.2011.
- **Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot.**, datë 25.7.2019, nga Ministria e Financave, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, drejtuar Thodhori Gravani, i cili rezultoi kreditor në ish firmën piramidale "KAMBERI ShPK", me kontratë nr. ***. Referuar kontratës rezultoi të ketë depozituar shumën 1.521.270 lekë dhe të ketë tërhequr vlerën 406.527 lekë.

Në proces-verbalin e datës 27.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti deklaroi se **"...nuk ka asnjë lidhje me aktivitetin Euro AI me nipt K06924209A. Ka kërkuar informacion pranë autoriteteve tatimore dhe nuk i është vënë në dispozicion asnjë e dhënë që të lidhet me të. (trajtuar më poshtë).**

*Ka ushtruar aktivitetin me NIPT L06824209V, vetëm në vitin 2010. Ka realizuar të ardhura vetëm për vitin 2010, kurse për vitet e tjera ka qenë me status pasiv dhe nuk ka kryer pagesa dhe veprime, kjo e vërtetuar dhe me shkresën e DRI Vlore, nr. ***, datë 08.08.2019 dhe nr. ***, datë 14.08.2019, ku dhe së fundmi me shkresën nr. ***, datë 26.09.2023, ku theksohet që qarkullimi është 0 lekë. Për të saktësuar ushtrimin e veprimtarive të dyta theksoi se për periudhën që ka ushtruar aktivitet si person fizik, në vitet 1995, 1996, 1997 dhe vitet 2004,*

2005, nuk ka qenë në marrëdhënie punë . Për vitin 2010, kur kishte aktive pjesën e licencës për vlerësues pasurie, **Ligji i Policisë nr. 9749, datë 04.06.2007, i cili ishte në fuqi në atë periudhë, e lejonte dhe kufizonte vetëm veprimtari private që pengonin plotësimin e kërkesave të detyrës si dhe në biznese që çonin në konflikt interesash me detyrën si punonjës policie.** Saktësoj që kjo lloj licence hyn në kategorinë e licencave që e merr pas një trajnimi në atë kohë në Ministrinë e Ekonomisë dhe është e përhershme për personin që certifikohet. Për aktivitetin me NIPT L06824209V ka aplikuar për regjistrimin e aktivitetit për shkak të mos ushtrimit të aktivitetit, pasi nuk po ri deklaronte më asnjë formular për zhvillimin e aktivitetit pavarësisht se ky aktiviteti është regjistruar në vitin 2016”.

- Lidhur me të ardhurat e deklaruara në vlerën 3.000.000 lekë (2004 - 2006), sqaroi se në këtë shumë është e përfshirë:
 - a) të ardhurat e realizuara nga aktiviteti me NIPT K56612221B, me objekt veprimtarie "Tregti me pakicë konfeksione". Referuar shkresave zyrtare nga tatimet, të ardhurat janë realizuar në shumën gjithsej 6.300.000 lekë dhe marzh i fitimi rreth 50%. Për kë të arsye fitimi neto është rreth 3.000.000 lekë. Në këtë shumë përfshihen edhe të ardhurat e realizuara nga aktiviteti privat me NIPT K66417203A, ushtruar nga M.B., motra e bashkëshortes.
 - b) Në të ardhurat e llogaritura në vlerën 4.000.000 lekë (1993 - 1998), janë përfshirë: të ardhurat nga emigracioni në vlerën 2.500.000 lekë (investuar te Kamberi në vlerën l. 500.000 lekë, pjesa tjetër për aktivitetin privat);
 - c) Të ardhura nga aktiviteti privat i regjistruar me NIPT nr. K56612221B, (qarkullimi i realizuar) në vlerën 7.000.000 lekë (fitimi neto 3.500.000 lekë). Nga ky fitim ka llogaritur humbje në firmën rentierë 1.000.000 lekë dhe shpenzime të tjera të cilat kanë zvogëluar vlerën e fitimit. Për sa i përket saktësisht të ardhurave të investuara në firmat rentierë saktësoi se përgjigjja nr. ***, datë 25.7.2019 e Ministrisë së Financave, që ka vënë në dispozicion është po ashtu korrekte dhe përputhet me dokumentacionin që ka depozituar veçse me një ndryshim, se vërtetimi në fjalë i jep shifrat të konvertuara në lekë me kursin e drahmisë që ishte në atë kohë.
 - d) Në lidhje me vërtetimin e transferimit të aktivitetit në vitin 2006 tek motra e bashkëshortes M.B., sqaroi se edhe pse nuk kishte pengesa ligjore për zhvillimin e këtij aktiviteti person fizik, kryen transferimin e aktivitetit për shkak të ngarkesës së punës dhe nevojës që zonja në fjalë të vetëpunësohej dhe të paguante sigurimet shoqërore për efekt pensioni. Për ta faktuar këtë bashkëlidh dokumentacionin fiskal (fotokopje licence, certifikatë regjistrimi, urdhra pagese që tregojnë ushtrimin e po të njëjtit aktivitet).

Konkluzion:

- * Subjekti citon Ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, konkretisht nenin 73 “Kufizimi për veprimtari të dyta”, ku pika 1 e tij, citoj: **Punonjësi i Policisë nuk mund të punësohet ose të kryejë veprimtari private, të cilat pengojnë plotësimin e kërkesave të detyrës. Në rastet e dy punësimit, punonjësi i policisë ka detyrimin të njoftoj paraprakisht strukturën përkatëse në DPPSH.**
- * Subjekti nuk vuri në dispozicion asnjë material shkresor në lidhje me pretendimet e mësipërme se ka ushtruar aktivitetin privat pa vënë në dijeni strukturat eprore. **Ligji është i qartë se edhe në rastet kur veprimtaria private nuk pengon plotësimin**

e detyrave si punonjës i policisë së shtetit ai ka “detyrimin” të njoftoj paraprakisht strukturën përkatëse në DPPSH.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

Në lidhje me shkresën e DPT Vlorë nr. V-Prot., datë 12.05.2023, e cila konfirmon se shtetasi **Thodhori Gravani**, rezulton i regjistruar pranë DRT, Vlorë, si administrator në shoqërinë “Euro-Al-Grup” ShPK., me Nipt K06924209A, prej datës 09.10.2000 dhe deklaratës së tij dhënë në proces-verbalin e datës 27.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, ku subjekti deklaroi se “...nuk ka asnjë lidhje me aktivitetin Euroal me nipt K06924209A”, rezultoi se:

- ✚ Me Repertor nr. ***, datë 10.08.2000, shtetasi Thodhori Gravani është paraqitur pranë noteres në cilësinë e përfaqësuesit të posaçëm të shtetasve grekë Christos Exarchos dhe Ioannis Katsieris.
- ✚ Shtetasi Thodhori Gravani i cili ka depozituar shumën prej 2.000.000 lek si nënshkrim i kapitalit të shoqërisë anonime pa ofertë publike “EURO-AL” sha. në bazë të prokurës së posaçme të legalizuar me datë 05.08.2000, me numër Lç** i regj.dep., datë 10.08.2000 bërë pranë noteres Jetmira Veraj, si përfaqësues ligjor i shtetasve të lart përmendur.

Në lidhje me konstatimet e trupës së vlerësimit, me emalin e datës 12.01.2024, “Disa sqarime ne lidhje me relacionin paraprak”, z, Thodhori Gravani, sqaron se “...me konstatimin nga komisioni i jashtëm i vlerësimit se figuronte një NIPT ku unë figuroja si administrator në vitin 2000 me Nipt K06924209A kam angazhuar një përfaqësues ligjor për verifikimet e këtij fakti. Duke u siguruar se me këtë nipt nuk ka pas aktivitet fiskal (deklarime, pagesa ose veprime të tjera), i jemi adresuar arshivës në QKB dhe në arkivin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Tiranë për të gjetur gjurmë të regjistrimit. Pasi siguroam kopje të këtyre dokumenteve dhe dukej qartazi se ishim para faktit që ishte nënshkruar në emrin tim, dhe falsifikuar nënshkrimi të ndodhur në këto kushte depozituar me datë 12.02.2020 kallëzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë ndaj noteres J. V.”

Konkluzion:

Në lidhje me konstatimin se rezulton administrator në shoqërinë “Euro-Al-Grup” SHPK, me Nipt K06924209A, prej datës 09.10.2000, subjekti i vlerësimit ka mbajtur qëndrime kontradiktore, në pyetjet⁴ që ILDKPKI i ka drejtuar në lidhje me këtë konstatim. Subjekti i ka bërë të ditura këto fakte në momentin kur i është paraqitur relacioni përfundimtar.

C. DETYRIME FINANCIARE

⁴ Në proces-verbalin e datës 27.9.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti deklaroi se “...nuk ka asnjë lidhje me aktivitetin Euroal me nipt K06924209A. Ka kërkuar informacion pranë autoriteteve tatimore dhe nuk i është vënë në dispozicion asnjë e dhënë që të lidhet me të”.

✚ Kredi bankare në Tirana Bank datë 23.5.2017, për blerje apartamenti. Data e fillimit 16.05.2017 data e maturimit 16.05.2033 Shuma totale 7.000.000 lekë. Detyrimi financiar 1.934.546 lekë.

- **Tirana Bank me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023**, konfirmon kredinë në emër të Thodhori Gravani dhe detyrimin financiar në datë 9.3.2023, në vlerën 1.896.573 lekë. Referuar lëvizjeve të llogarisë, rezulton se vlera e deklaruar nga subjekti prej 1.934.546 lekë i referohet detyrimit në datë 26.1.2023.
- Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në data të ndryshme dhe konkretisht, subjekti deklaroi gjendje e kredisë në Tirana Bank në datë 26.1.2023, ndërsa konfirmimi i bankës është i datës 09.03.2023.
- Kontratë huaje me person fizik pa interes, me marrëveshje mes palëve për plotësim blerjen e banesës. Detyrimi financiar 2.000.000 lekë.
(*Trajtuar më lart*).

D. SHPENZIMET E DEKLARUESHME I

✚ Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur. Periudha 01.01.2022 — 31.12.2022

Shpenzime gjatë vitit të fundit kalendarik. **Shuma 120.000 lekë.**

- **FSHU me shkresën nr. *** prot., datë 18.05.2023**, konfirmon se në emër të Thodhori Gravani, për periudhën deri në datë 09.03.2023, identifikohet një abonent në instancën Tiranë me nr. TRM110485637324.

Vlera e shpenzuar gjatë periudhës dhjetor 2021 - nëntor 2022, në **total 91.280 lekë.**

- Me gjeneralitetet S.G. rezulton një kontratë furnizimi me energji elektrike në instancën Sarandë.

- **Shoqëria Rajonale Ujësjellës —Kanalizime Tiranë, me shkresën nr. 13/33 prot., datë 16.06.2023**, konfirmon se në emër të Thodhori S.G., rezulton kontrata nr. 378831-1, për objektin me adresë në "Selitë ", status aktiv dhe detyrime të likuiduara deri në mars 2023. Bashkëlidhur kontrata e blerjes së apartamentit nga Thodhori Gravani nr. 1003 rep., nr. *** kol., datë 10.3.2017 dhe mjete identifikues i tij.

Vlera e shpenzuar gjatë periudhës dhjetor 2021 - mars 2023, në **total 36.000 lekë.**

- **Shoqëria Rajonale Ujësjellës — Kanalizime Vlorë, me shkresën nr. 13/46prot., datë 16.6.2023**, konfirmon se në emër të Thodhori S.G., rezulton kontrata nr. 24671, për objektin me adresë në Lagjja "Pavarësia " Vlorë, status aktiv dhe detyrime të likuiduara deri në mars 2023.

Vlera e shpenzuar gjatë periudhës dhjetor 2021 dhjetor 2022, në **total 11.255 lekë.**

- **13 Shoqëritë Rajonale të Ujësjetës —Kanalizime, me shkresat nr. 13/34 - 13/45; nr. *****, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur.
- **Vodafone Albania , me shkresën nr. ***, datë 14.7.2023**, konfirmon për shtetasin: Thodhori Gravani një numër telefoni aktiv (...180) me vlerë të shpenzuar për vitin 2022 në **vlerën totale prej 25.540 lekë**
- Edlira Gravani një numër telefoni aktiv (...213) me **vlerë të shpenzuar 16.200 lekë**
- S.G. dy numra aktiv telefoni (...977), i cili **nuk ka kryer rimbushje** për vitin 2022 si dhe (...634), në **vlerën 2.920 lekë**.
- **One Albania sh.a me shkresën nr. ***, datë 20.6.2023**, konfirmon se Thodhori Gravani, rezulton i regjistruar pranë kompanisë me nr. 069....369. Për periudhën 1.1.2022 - 3.12.2022, **vlera totale e shpenzuar është 5.000 lekë**. Bashkëlidhur kontrata dhe mjete identifikues.
- **Albania Satellite Communications ShPK me shkresën nr. *** prot, datë 15.5.2023**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- **Abissnet sh.a me shkresën nr. ***, datë 11.5.2023**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
- **Digicom sh.a, me shkresën nr. *** prot, datë 12.5.2023**, nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

Në proces-verbalin e datës **17.7.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *“kontrata e konfirmuar nga FSHU, me gjeneralitetet S.G. i referohet banesës në emër të babait në Vagalat, Sarandë”*.

Subjekti paraqiti:

- Librezat e energjisë elektrike dhe ujit, për të dy apartamentet, vlerë totale e faturuar në shumën **142.000 lekë**.

Në proces-verbalin e datës **27.09.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti paraqiti kopjet e faqeve të para të librezave të OSHEE: nr. M/637324, Rruga "K. Botanik"; nr. 31055 në Vlorë dhe të Ujësjetës nr. 378831-1 në Selitë dhe nr. 24671.

Në Proces-verbalin e datës **17.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti paraqiti certifikatën e pronësisë së pasurisë nr. 703 ZK 3692 në Vagalat, Sarandë, regjistruar në emër të babait S.G..

Shpenzimet e deklaruara për Ujë + drita + telefoni + internet, gjatë periudhës së sipërcituar. me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, rezultojnë **në total rreth 200.000 lekë**.

E. SHPENZIMET E DEKLARUESHME II

- ✚ Deklarimet për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e

qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara. Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022:

- Udhëtim personal në Greqi, 2 ditë, viti 2022. **Akomoduar tek familjarët.**
- Udhëtim personal në Barcelonë, 4 ditë, viti 2022. **Shuma 600 euro.**
- Udhëtim djali në Itali, 4 ditë, viti 2022. **Shuma 500 euro.**
- Udhëtim djali në Mal të Zi, 1 ditë, viti 2022. **Shuma 120 euro.**

Në proces-verbalet e datës 17.07.2023 dhe 27.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti paraqiti:

- Urdhër nr. 5489 prot. datë 30.7.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për caktimin e kryerjes së shërbimeve jashtë shtetit (Stamboll, Turqi) gjatë periudhës 16 - 21 gusht 2021, pjesë e të cilit është punonjësi Thodhori Gravani.
- Urdhër nr. 3323 prot., datë 4.6.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për caktimin e kryerjes së shërbimeve jashtë shtetit (Romë, Itali), gjatë periudhës 14 - 18 qershor 2021, pjesë e të cilit është punonjësi Thodhori Gravani.
- Urdhër nr. 4298 prot., datë 14.6.2022, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për caktimin e kryerjes së shërbimeve jashtë shtetit (Beograd, Serbi) gjatë periudhës 20 - 23 qershor 2021, pjesë e të cilit është punonjësi Thodhori Gravani.
- Urdhër nr. 6288 prot. datë 5.10.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për caktimin e kryerjes së shërbimeve jashtë shtetit (Paris, Francë), gjatë periudhës 19 - 22 tetor 2021, pjesë e të cilit është punonjësi Thodhori Gravani.

Konfirmim nga sistemi TIMS për subjektin dhe familjarët e tij, ku vërtetohen lëvizjet jashtë shtetit, si më poshtë vijon:

Thodhori Gravani:

Dalje 14.6.2021 - hyrje 18.6.2021;
Dalje 16.8.2021 - hyrje 21.8.2021;
Dalje 19.10.2021 -hyrje 22.10.2021;
Dalje 15.3.2022 - hyrje 19.3.2022;
Dalje 10.6.2022 - hyrje 12.6.2022;
Dalje 20.6.2022 - hyrje 23.6.2022.

Stefan Gravani:

Dalje 26.6.2021 - hyrje 27.6.2021;
Dalje 22.3.2022 - hyrje 22.3.2022;
Dalje 18.11.2022 - hyrje 22.11.2022.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje - daljeve nga RSH gjatë periudhës 2020 — 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të. Shpenzimet e deklaruarra për udhëtimet private, personale (dhe të personave të lidhur, gjatë periudhës së sipërcituar, **rezultojnë në total rreth 1.220 euro**, konvertuar rreth **140.000 lekë**.

F. SHPENZIMET E DEKLARUESHME III

Për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, " të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit - Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e Plotësimit të formularit të deklarimit të Pasurisë.

✚ Nuk ka deklarime.

Në proces-verbalet e datës **17.07.2023** dhe **27.09.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se "...djali ka studiuar në universitet publik. Për periudhën 2011 - 2014, djali ka studiuar në shkollën e mesme jo publike "Perla " Vlorë dhe është trajtuar me bursë.

Subjekti paraqiti:

- Vërtetim nr. ***, datë 25.9.2023, nga Shkolla e Mesme Jo publike "Perla" Vlorë për nxënësin S.G., i cili ka ndjekur shkollën gjatë viteve 2011 - 2014, me bursë të plotë.

Konkluzion:

- ✓ Konfirmohen shpjegimet e dhëna me dokumentacionin e paraqitur, lidhur me shkollimin e djalit

G. DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - EDLIRA GRAVANI

DEKLARIMI I PASURIVE

✚ Llogari page në BKT, me vlerë 5.603 lekë. Pjesa takuese 100%. Balanca 31.12.2022.

✚ **Banka Kombëtare Tregtare. me shkresën nr. *** prot., datë 09.05.2023**, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Edlira Gravani, me gjendje në dt. 09.03.2023, në vlerën **91.680 lekë**. Në datë 31.12.2022, gjendja në llogari në vlerën **5.603 lekë**.

- ✓ Bashkëshortja e subjektit deklaron gjendjen e llogarisë në datë 31.12.2022. ndërsa konfirmimi i bankës është i datës 9.3.2023.

✚ **Depozitë në OTP Bank**, me vlerë **1.932.425 lekë**. Pjesa takuese 100%. Çelur në Bankën Societe Generale Albania dhe është mbartur dhe kaluar tek kjo bankë me kursime familjare ndër vite. Balanca 31.12.2022.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

✚ **OTP Bank me shkresën nr. *** prot., datë 05.05.2023**, konfirmon llogari kursimi në emër të Edlira Gravani, me gjendje në datë 09.03.2023, vlerën **1.932.425 lekë**.

- Evidentohet se llogaria është çelur në datë **02.07.2011**, me anë të depozitimit cash nga Edlira Gravani, të shumës **300.000 lekë**.
- Në datë 20.07.2012 është depozituar shuma **300.000 lekë**.
- Në datë 03.09.2012 maturuar depozita në vlerën 615.000 lekë dhe tërhiqet cash shuma 600.000 lekë.
- Në datë 27.05.2013, depozituar **495.000 lekë**.
- Në datë **05.03.2014**, shtetasi **H.Zh. depoziton cash shumën 250.000 lekë, me përshkrimin "kalim për detyrim i Magit"**
- Në periudhën mars 2014 dhe maj 2014, Edlira Gravani depoziton **138.600 lekë**.
- Në vijim, Edlira Gravani depoziton
212.000 lekë, datë 27.05.2015;
250.000 lekë datë 26.5.2016;
165.000 lekë, datë 29.5.2017;
100.000 lekë, datë 12.11.2018;
172.000 lekë, datë 04.03.2019.

Në proces-verbalin e datës **17.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se “...shtetasi H. Zh. është vëllai i shtetases M. Sh., e cila citohet në përshkrimin e transfertës, shtetase e cila ka qenë kolege me bashkëshorten në shkollën "Ismail Qemali" Vlorë. Kjo vlerë ka qenë një detyrim që kanë patur bashkëshortja me kolegen”.

Në proces-verbalin e datës **17.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se “...shumat e depozituara janë realizuar nga të ardhurat që kanë patur në dispozicion në atë periudhë, akumuluar pjesërisht nga aktiviteti privat dhe pjesërisht nga të ardhurat nga punësimi. Fondet janë tërhequr nga banka të tjera ku kreditohen pagat.

Konstatim

- ✚ Në datë 05.03.2014, shtetasi **H. Zh.**, depoziton cash shumën **250.000 lekë**, me përshkrimin "kalim për detyrim i Magit".
- **Trupa e Vlerësimit** me qellim verifikimin e deklarimeve të subjektit të vlerësimit se depozitimi cash i shumës 250.000 lekë, me përshkrimin "kalim për detyrim i Magit", në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, kreu verifikimet përkatëse në regjistrin e gjendjes civile dhe në sistemin TIMS, nga ku rezultoi se shtetasi **H.N.Zh. nuk rezulton të këtë motër, të quajtur “Megi”**. Në përbërjen familjare është vetëm një vëlla i quajtur **B. N. Zh.**
- ✚ Në lidhje me deklarin e subjektit të vlerësimit, referuar proces – verbalit të datës **17.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI, ku ka sqaruar se: “...shumat e depozituara janë realizuar nga të ardhurat që kanë patur në dispozicion në atë periudhë, akumuluar pjesërisht nga aktiviteti privat ...”, trupa e vlerësimit i kërkoj shpjegime të mëtejshme subjektit se kujt biznesi privat i referohet, pasi nga të dhënat e faktit dhe dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i vlerësimit, aktiviteti me **NIPT K56612221B** është mbyllur në vitin 2006, ndërsa aktiviteti i kunatës M.B. me **NIPT K66414203A**, ka kaluar në status

pasiv në vitin 2009 dhe është mbyllur në 2011, ndërkohë që depozitimet në llogari nga ana e bashkëshortes së subjektit të vlerësimit janë bërë gjatë periudhave **2012 - 2019**.

Subjekti i vlerësimit në përgjigjen e tij u shpreh se, mbi deklarin " *...akumuluar pjesërisht nga aktiviteti privat...*", i referohet bizneseve familjare të sipërpërmendur edhe pse janë mbyllur përkatësisht në 2006 dhe 2009.

- **Trupa e vlerësimit** referuar analizës mbi të ardhurat e fituara nga biznesi (*trajtuar më sipër*) ku nuk vërtetohet fitimi i pretenduar ndër vite, **konstaton se subjekti i vlerësimit nuk pasqyroj argumente dhe prova bindëse, që të mbështesë pretendimin e tij.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- **Të ardhura nga punësimi si arsimtare për periudhën 1996 - 1999**, sipas vërtetimit nga Njësia Administrative Novoselë. Shuma e të ardhurave 255.188 lekë.
- **Të ardhura nga paga për periudhën 1997 - 2007**, sipas vërtetimit nga Bashkia Vlorë. Shuma e të ardhurave 1.520.470 lekë.
- **Të ardhura nga aktiviteti privat - biznes familjar për periudhën 2004 - 2010**. Shuma e të ardhurave 1.500.000 lekë.
- **Të ardhura nga paga për periudhën 2008 - 2017**, sipas vërtetimit nga DAR Vlorë. Shuma e të ardhurave 4.955.379 lekë.
- **Të ardhura nga paga për periudhën 2018 - 2022**, sipas vërtetimeve nga DAR Tiranë. Shuma e të ardhurave 3.460.820 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- **Vërtetim nga Komuna Vllahinë**, për bazën e vlerësuar të kontributeve të deklaruara nga shtetasja Edlira B.. Për periudhën 16.09.1995 - 31.11.1996, ka përfituar të ardhura neto pranë shkollës Vllahinë, në total 86.878 lekë.
- **Vërtetim nga Njësia Administrative Novoselë**, për bazën e vlerësuar të kontributeve të deklaruara nga shtetasja Edlira B.. Për periudhën 06.04.1998 - 20.9.1999, ka përfituar të ardhura neto, në total 168.310 lekë.
- **Vërtetim nga Bashkia Vlorë**, për bazën e vlerësuar të kontributeve të deklaruara nga shtetasja Edlira Gravani për periudhën shtator 1999 - dhjetor 2007, ka përfituar të ardhura neto, në total 1.520.420 lekë (gjatë periudhës shtator 1999 - mars 2005, ka përfituar të ardhura në vlerën totale rreth 908.187 lekë).
- **Vërtetim nga Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë**, për bazën e vlerësuar të kontributeve të deklaruara nga shtetasja Edlira Gravani. Për periudhën janar 2008 - dhjetor 2017, ka përfituar të ardhura neto, në total 4.955.380 lekë.
- **Vërtetim nr. *** prot., datë 26.07.2022**, nga Zyra Vendore Arsimore Vlorë për Edlira Gravani, e cila për periudhën janar 2018 - tetor 2019, ka përfituar të ardhura neto në vlerën totale prej 1.075.746 lekë.
- **Vërtetim nr. *** prot., datë 25.7.2022**, nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë për Edlira Gravani e cila për periudhën tetor 2019 - dhjetor 2019, ka përfituar të ardhura neto në vlerën totale prej 161.443 lekë.

- **Vërtetim nga ZVA Tiranë**, për bazën e vlerësuar të kontributeve të deklaruara nga shtetasja Edlira Gravani. Për periudhën janar 2020 - dhjetor 2020, ka përfituar të ardhura neto, në total 705.464 lekë.
- **Vërtetim nga ZVA Tiranë**, për bazën e vlerësuar të kontributeve të deklaruara nga shtetasja Edlira Gravani. Për periudhën janar 2021 - dhjetor 2021, ka përfituar të ardhura neto, në total 778.742 lekë.
- **Vërtetim nr. *** prot., datë 1.3.2023**, nga ZVA Tiranë, për të ardhurat e realizuara nga shtetasja Edlira Gravani, gjatë periudhës janar 2022 - dhjetor 2022, në total 779.144 lekë.
- **Shkresa kthim përgjigje nr. ***, datë 23.7.2019**, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë, sipas së cilës M.B., figuron e regjistruar si Person Fizik me NIPT K66417203,4. Subjekti ka deklaruar qarkullim për vitin 2006, në vlerën 2.600.000 lekë.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✚ **Banka Kombëtare Tregtare, me shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2023**, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Edlira Gravani, në të cilën janë kredituar pagat gjatë periudhës 01.04.2005 - 03.03.2023, në shumën totale prej **9.435.000** lekë.
- ✚ **ISSH me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2023**, konfirmon të ardhurat bruto/neto të përfituara nga Edlira Gravani, gjatë periudhës janar 2012 - mars 2023, pranë Drejtorisë Arsimore, Zyrës Vendore Arsimore Vlorë-Himarë dhe Drejtorisë Arsimore Qytet.

Në **proces-verbalin e datës 27.09.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se **shuma 1.500.000 lekë**, janë të ardhura që bashkëshortja akumulonte kur aktiviteti privat kishte kaluar në emër të M.B. dhe kanë punuar njëkohësisht në marrëdhënie me motrën e saj. Sqaroi se gjatë viteve 2006 - 2007 bashkëshortja ndiqte aktivitetin privat të kaluar nga ai te e motra e bashkëshortes dhe të ardhurat e realizuara nga fitimi i kompanisë janë ndarë në marrëveshje me motrën e saj, pavarësisht se nuk figuronte në dokumentet ligjorë të kompanisë.

Në **proces-verbalin e datës 17.10.2023**, subjekti sqaroi se të ardhurat e deklaruara nga bashkëshortja, në shumën 1.500.000 lekë, janë krijuar nga aktiviteti i transferuar te kunata dhe kjo vlerë është deklaruar si pjesë e të ardhurave të tij (deklaruar 3.000.000 lekë) dhe gjithashtu te rubrika e të ardhurave të bashkëshortes. Kjo për arsye sepse pas transferimit të aktivitetit fillestar të tij te kunata, aktiviteti është ndjekur dhe punuar gjithashtu nga bashkëshortja.

Subjekti paraqiti:

- Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.10.2023, e shtetases M.B., e cila konfirmon se gjatë viteve 2006 - 2009 ka ushtruar aktivitet privat në fushën e tregtimit me pakicë, konfeksioneve, regjistruar me NIPT K66417203A. Si kapital i këtij aktiviteti ka shërbyer transferimi i aktivitetit (pajisje, aksesori furnizimi dhe stoku), me të njëjtën veprimtari që ushtronte më parë kunati i saj Thodhori Gravani në vitin 2004. Pas transferimit të aktivitetit dhe administrimit prej saj, të ardhurat i ka ndarë me motrën e saj Edlira Gravani, ku kjo e fundit ka përfituar vlerën rreth 1.500.000 lekë, të cilat janë përfituar periodikisht sipas bilancit të aktivitetit. Të ardhurat e bashkëshortes nga

pagat. shpërblimet, për periudhën nëntor 1995 - mars 2023. konfirmohen në vlerën totale rreth 10.600.000 lekë të ardhurat e bashkëshortes, nga aktiviteti privat - biznes familjar, për periudhën 20.04.2010. në vlerën **1.500.000 lekë**, janë trajtuar në rubrikën e të ardhurave të subjektit si pjesë e të ardhurave, deklaruar gjithashtu prej tij. Shuma ka shërbyer pjesërisht për pagesën e këstit të dytë të apartamentit në Sarandë në vitin 2010.

Konkluzion:

- Të ardhurat e deklaruara nga bashkëshortja e subjektit dhe të pretenduara si të krijuara nga aktiviteti i transferuar tek kunata dhe të deklaruara si pjesë e të ardhurave të tij dhe njëkohësisht të bashkëshortes, janë analizuar gjerësisht dhe sqaruar nga trupa vlerësuese më lart në burimin e krijimit të pasurisë nr. 3.(*shih me sipër*)
- Gjithashtu në sqarimet e subjektit se “ *gjatë viteve 2006 dhe 2007 bashkëshortja ndiqte aktivitetin privat të kaluar nga ai te e motra e bashkëshortes*”, ky qëndrim i subjekti përtej vërtetimit të faktit dhe dokumentacionit shkresor justifikues të paraqitur nga ai, viti 2007 nuk rezulton në asnjë rast që motra e bashkëshortes të ketë ushtruar aktivitet privat.
- **Në tërësinë e deklarimeve dhe sqarimeve të subjektit të vlerësimit të cilat nuk janë koherente**, trupa vlerësuese gjykon se edhe në kuptimin e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk arrin të bindë trupin vlerësuese, që përfitimi i këtyre të ardhurave personale nga personi i lidhur M.B. për bashkëshorten e subjektit, nuk ka qenë në keqbesim (sa u takon detyrimeve ndaj shtetit) dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues për të pasqyruar të kundërtën.

H. DEKLARIMI I DJALIT – STEFAN GRAVANI

DEKLARIMI I PASURIVE

Pasuria nr. 1

- ✚ Ullishte me sip. 1.320 m², 956 m², 6.600 m², 8.121 m², Qeparo, Vlorë. Pasuritë janë përfituar si përpjesëtim i pasurisë së trashëguar nga nëna ime Anila Gravani, si trashëgimtare, sipas vendimit të gjykatës nr. ***, datë 21.1.2013. Zotëron 20%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 27.10.2014, të pasurisë "ullishte" me sip. 1.170 1112, ndodhur në Qeparo, Vlorë, regjistruar me nr. ***, në emër të bashkëpronarëve M. T., Q. T., S.T., S.G., A.T., pjesë takuese 1/5 secili.

- Certifikatë për vërtim pronësie, datë 27.10.2014, të pasurisë "ullishte" me sip. 956 m², ndodhur në Qeparo, Vlorë, regjistruar me nr. ****, në emër të bashkëpronarëve M. T., Q. T., S.T., S.G., A.T., pjesë takuese 1/5 secili.
 - Certificate për vërtetim pronësie, datë 27.10.2014, të pasurisë "ullishte" me sip. 6.600 m², ndodhur në Qeparo, Vlorë, regjistruar me ë. 74/1/3, në emër të bashkëpronarëve Q. T., S.T., S.G., A.T., pjesë takuese 1/5 secili.
 - Certificate për vërtetim pronësie, datë 27.10.2014, të pasurisë "ullishte" me sip. 8.121 m², ndodhur në Qeparo, Vlorë, regjistruar me nr. 140/11, në emër të bashkëpronarëve Q. T., S.T., S.G., A.T., pjesë takuese 1/5 secili.
 - Vendim nr. 75, dt.21.1.2013, i Gjykatës së Rrethit Vlorë, për lëshimin e trashëgimisë për të ndjerin V. T., duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë shtetasit M. T. (bashkëshortja), Q. T. (i biri), S.T. (i biri), S.G. (nipi), A.T., pjesë takuese 1/5 secili.
- ✘ **ASHK, Drejtoria Vendore Vlorë. me shkresën nr. *** prot., datë 31.7.2023**, nuk i konfirmon pasuritë në emër të S.G..

Në proces-verbalin e datës **17.7.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se sipërfaqja 1.320 m² është lapsus gjatë plotësimit të deklaratës, pasi sip. e saktë është 1.170 m², sipas certifikatës.

Konkluzion:

- ✓ ASHK nuk konfirmon pasuritë e deklaruara.
- 🚩 Ullishte me sip. 250 m², Qeparo, Vlorë. Kjo pasuri është përfituar si përpjesëtim i pasurisë së trashëguar nga nëna ime Anila Gravani, si trashëgimtare kjo, sipas Vendimit të Gjykatës nr. ***, datë 21.1.2013. Zotëron 2096.

Bashkëlidhur deklaratës:

Certificate për vërtetim pronësie, datë 27.10.2014, te pasurisë "ullishte" me sip 250 m², nga e cila "ndërtesë " me sip. 76 m², ndodhur ne Qeparo, Vlorë, regjistruar me nr. ***, në emër të bashkëpronarëve M. T., Q. T., S.T., S.G., A.T., pjesë takuese 1/5 secili.

Në proces-verbalin e datës **17.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se objekti që figuron në certificate është ekzistues, ndërtuar para viteve 1990 ne të cilën banon gjyshja e djalit. Sqaroi se prej tij, nuk janë bërë investime në këto të pasuri.

Në proces-verbalin e datës **17.10.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti paraqiti fotografi të shtëpisë në Qeparo, Vlorë.

- ✘ ASHK Drejtoria Vendore Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 31.07.2023, nuk i konfirmon pasuritë ne emër të S.G..

Konkluzion:

- ✘ Deklarimi bazohet në dokumentacionin e dorëzuar dhe shpjegimet e dhëna.
ASHK nuk konfirmon pasuritë e deklaruara.
Subjekti ka dokumentuar ndërtesë me sip. 76 m², në Qeparo, Vlorë e cila sipas shpjegimeve të dhëna është banesa e gjyshes, e ndërtuar para viteve 1990, ku djali zotëron 20 % me dëshmi trashëgimie.
- 🚩 Llogari page në Raiffeisen Bank, vlerë 55.000 lekë. Pjesë takuese 100%. Balanca 31.12.2022

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- ✓ **Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023**, konfirmon llogarinë e pagës në emër të S.G., me gjendje në datë 09.03.2023 vlerën 66.729 leke. Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në data të ndryshme dhe konkretisht, djali i subjektit deklaroi gjendjen e llogarisë në Raiffeisen Bank në datë 31.12.2022 ndërsa konfirmimi i bankës është i datës 09.03.2023.

Pasuria nr. 2

- 🚩 Llogari rrjedhëse në Intesa San paolo Bank nr. 65332635101, vlerë 0 leke. Pjesë takuese 100 %. Balanca 31.12.2022.
- **ISP Bank me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023**, konfirmon llogarinë në emër të shtetasit S.G. nr. 65332635101, mbyllur në datë 13.10.2022.
- ✓ Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ndodhur për shkak të paraqitjes së tyre në data të ndryshme dhe konkretisht, djali i subjektit deklaroi gjendjen e llogarisë në Raiffeisen Bank në datë 31.12.2022 ndërsa konfirmimi i bankës është i datës 09.03.2023.

Pasuria nr. 3

- 🚩 Depozitë në Intesa San paolo Bank, vlerë 492.000 lekë. Depozitë e çelur në vitin 2007 nga prindërit dhe e maturuar pas moshës 18 vjeç. Pjesë takuese 100%. Balanca 31.12.2022.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

- **ISP Bank me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023**, konfirmon depozitën në emër të shtetasit S.G., me gjendje në datë 09.03.2023, vlerën prej 491.545 lekë. Depozita është çelur në datë 26.02.2007, me anë të depozitimit fillestar prej 100.000 lekë, shlyer nga shtetasja M.B.. Në vijim janë kryer depozitime cash prej 100.000 lekë çdo vit, gjatë periudhës 2008 - 2010.

Në proces-verbalin e datës 27.09.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se “në lidhje me këtë depozitë, ku figurojnë disa depozitime nga shtetasja M.B., bëhet fjalë për motrën e gruas (kunata), e cila thjesht shlyente depozitim pas të ardhurat ishin të familjes”.

Konkluzion:

- ✘ **Nuk vërtetohet nga deklarimi i subjektit apo nga provat e paraqitura se shtetasja M.B., njëkohësisht motra e bashkëshortes (kunata), se depozitimet e kryera nga kjo shtetase kanë qenë të familjes së subjektit.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura në Akademinë e Sigurisë dhe në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Viti 2021. Shuma e të ardhurave 502.456 lekë.
- Të ardhura në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Viti 2022. Shuma e të ardhurave 722.856 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. *** prot., datë 23.2.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë, Tiranë për S.G., i cili paguhet me pagë mujore neto 60.238 lekë.
- Vërtetim nr. *** prot., datë 16.2.2022 nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë për S.G., i cili për periudhën 21.09.2021 - 31.12.2021 ka realizuar të ardhura në vlerën totale 189.021 lekë.

✚ **Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023**, konfirmon llogarinë e pagës në emër të S.G., në të cilën janë kredituar pagat gjatë periudhës 02.03.2021 - 02.03.2023, vlerën **totale prej 1.555.000 lekë**.

✚ **ISSH me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2023**, konfirmon të ardhurat bruto/neto të përfituara nga S.G. gjatë periudhës shkurt 2021 - mars 2023, pranë Akademisë së Sigurisë dhe Drejtorisë së Policisë së Përgjithshme të Policisë .

✚ Të ardhurat e djalit të subjektit nga pagat. për periudhën shkurt 2021 - mars 2023. konfirmohen në vlerën **totale rreth 1.555.000 lekë**.

- **Në Deklaratën e Pasurisë** për vlerësimin kalimtar, subjekti Thodhori Gravani ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile, si dhe adresën e plotë ku banon: Rruga” Alla” Nd.3, H.9, Ap. 14 Farkë, selitë, Tiranë.

Në proces-verbalin e datës 17.7.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se “...adresa si më sipër, i përket apartamentit në Tiranë. Djali gjithashtu banon në këtë apartament.”

Rezulton se adresa e deklaruar nga subjekti i referohet apartamentit të deklaruar në pronësi të tij dhe trajtuar më lart.

✚ Në deklaratën "Pas Largimit nga Funkzioni 2004", subjekti ka deklaruar se disponon një sipërfaqe tokë bujqësore 2 dynym në Vagalat, Sarandë, përfituar nga ligji 7501.

✘ ASHK Drejtoria Vendore Sarandë, me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2023, nuk e konfirmon pasurinë në emër të subjektit.

Në proces-verbalin e datës 17.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *"...babai i tij, S.G, ka qenë anëtar i familjes bujqësore në fshatin Vagalat, Sarandë. Me cilësinë e kryefamiljarit, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën referuar Aktit të Marrjes në Pronësi të Tokës, nr. 1053/1993, ka marrë në pronësi 18.163 m² tokë të zërave kadastrale: arë 16.529 m², pemëtore 229 m², ullishte 1105 m² dhe truall 300 m². Referuar certifikatës familjare nr. 013299380, datë 16.10.2020, familja bujqësore me kryefamiljar babait S.G., në datën 01.08.1991, përbëhej nga pesë frymë, dy prindërit dhe tre fëmijët. Toka, ndonëse "de facto" ishte në bashkëpronësi të pandarë të gjithë anëtarëve të familjes, "de jure " mbeti pronë e babait S.G.. Këtë status, ka edhe sot e kësaj dite. Ajo u regjistrua në ZRPP — Sarandë, në datën 27.09.2014, në emër të kryefamiljarit dhe këtë situatë juridike ka edhe sot e kësaj dite".*

Në vitin 2004, kur u bë për herë të parë subjekt i Deklarimit të Pasurisë, deklaroi me ndërgjegje faktin se ishte pronar "de facto" i 2.000 m² toke, të ndodhur në fshatin Vagalat, megjithëse "de jure" referuar Aktit të Marrjes në Pronësi, nr. 1053/1993, ajo ishte në pronësi të babait, dhe më tej, po në emër të babait të tij S.G., u regjistrua në ZRPP-Sarandë, ku si e tillë figuron edhe aktualisht. Në deklaratimet e mëvonshme të pasurisë, tokën në fjalë, nuk e deklaroi nisur nga fakti se nuk mund të konsiderohej as pronar dhe as bashkëpronar i saj, përderisa nuk ishte pjesëtar në mënyrë që të regjistrohej në emrin të tij.

Subjekti paraqiti:

- **Certifikate familjare** nr. 013299380, datë 16.10.2020, ku shtetasi Thodhori Gravani figuron pjesëtar i familjes bujqësore.
- **Akti i marrjes së tokës në pronësi** nr. 1053/1993, nxjerrë në emër të K/familjarit S.G..
- **Certifikata pronësie** të lëshuara nga ZRPP Sarandë, në emër të babait S.G. për pasuritë 138/16 lloji arë, me sip. 1.560 m²; nr. 229/3 lloji arë, me sip. 4.597 1712; nr. 273/13 lloji arë, me sip. 5.638 m².
- **Testamente datë 18.8.2009**, të shtetasve S.G. (babai) dhe Vanthia Gravani (nëna), në të cilat deklarohet fakti, se ata, duke e konsideruar të gjithë tokën prej 18.163 m² të përfituar me anë të AMTP, u 'a lënë në pronësi të barabartë fëmijëve të tyre. Subjekti dha sqarime lidhur me tokën bujqësore në emër të babait, në Vagalat. Sarandë, përfituar nga ligji 7501. ASHK nuk e konfirmon pasurinë në emër të subjektit.

✚ **Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka e Parë e Investimeve, Banka Amerikane e Investimeve Union Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Lagdçlga.sg, Credins Invest, Unioni Financiar Tiranë, Easy Pay, Fondi Besa, NOA, Iute Credit, Kreda.al**, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, **çka konfirmohet me deklarinimin.**

ASHK, zyrat/drejtoritë vendore, Tirana Rurale 2, Tiranë Veri Tiranë Jug, Kamëz, Vorë, Zonave të Stimuluara, Shkodër, Sarandë, Tepelenë, Tropojë, Mirditë, Fier, Korçë, Berat, Pogradec, Lushnje, Devoll, Krujë, Gjirokastër, Librazhd Mallakastër, Kolonjë, Elbasan, Kukës Kavajë, Malësi e Madhe Kuçove, Bulqizë, Skrapar, Kurbin, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.

Raiffeisen Bank, me shkresën nr. 13/2 prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Thodhori Gravani, në të cilën ndër vite evidentohet se në datë 13.12.2022, shuma 150.000 lekë, kalon për pagesë detyrimi në favor të A. Q.

Në proces-verbalin e datës **17.7.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se “...shtetasi A. Q. është i afërmi i tij (vjehrri i kunatit) i cili është emigrant në Greqi dhe fondet i janë transferuar për pagesat për veprimet hartografike për ndarjen e pasurive të familjes së tyre”. Gjithashtu dha sqarime lidhur me transaksionet e konfirmuara nga Raiffeisen Bank.

× **ISP Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2023**, konfirmon se shtetasi Thodhori Gravani ka patur llogari pranë bankës, në monedhat ALL/EUR.

Në llogarinë ALL, Thodhori Gravani depoziton cash në datë 20.07.2004, shumën **1.525.804 lekë**, vlerë kjo e tërhequr periodikisht dhe **datë 27.09.2004**, tërhequr në vlerën 500.000 lekë. Gjendja në datë **31.12.2014**, në vlerën 212.954 lekë dhe në datë **30.12.2005**, në vlerën 9.728 lekë.

Në llogarinë EUR, çelur në datë **11.10.2004**, nuk janë kryer veprime bankare deri në datë **19.11.2013**, kur Thodhori Gravani depoziton shumën 7.350 euro dhe i transferon në favor të shtetasit H.T., në shtetin italian, me përshkrimin "**transfertë kunatit për ndihmë financiare**".

Në proces-verbalin e datës **17.07.2023**, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se “...në këtë periudhë nuk ka qenë në marrëdhënie pune dhe ushtronte aktivitet privat, me nr. NIPT K56612221B. Të ardhurat janë pikërisht me burim aktivitetin privat. Tërheqja e fondeve është kryer në funksion të aktivitetit privat dhe shpenzimeve familjare. Depozitimi i shumës 7.350 euro ka si burim të ardhurat e disbursuar nga kredia e marrë në Raiffeisen, në vlerën 704.000 lekë, konvertuar në euro, ri depozituar dhe transferuar për blerjen e automjetit me targë AA717HY. Përshkrimi i vendosur në transfertën bankare, nuk përkon me veprimin e tij dhe është vendosur sipas vetë punonjëses së bankës. Deklaroi se H.T. është bashkëshorti i M.B.(kunata) i cili jeton në Itali...”

Subjekti dha sqarime lidhur me transaksionet e konfirmuara nga ISP Bank. Kredia në Raiffeisen Bank trajtohet në vijim.

Dokumentacioni i burimit të krijimit të shumës së depozituar rreth 1.500.000 lekë nga aktiviteti privat me NIPT K56612221B është trajtuar më sipër në rubrikën e deklarimit të ardhurave të subjektit.

Tirana Bank, me shkresën nr. *5 prot., datë 12.05.2023**, konfirmon llogari në emër të shtetasit Thodhori Gravani, ku figuron si vijon:

Për periudhën **gusht 2017 - janar 2018** janë kryer depozitime cash periodikisht në vlerën 20.000 lekë, nga shtetasit **L.H,E.H.**, me të cilat janë kryer shlyerjet e kësteve të kredisë.

Në datë 20.01.2021 shtetasi **A.Sh.**, depoziton shumën 300.000 lekë, me përshkrim pagesë këst kredie.

Në proces-verbalin e datës 17.07.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit, subjekti sqaroi se *“shuma 500.000 lekë, tërhequr në datë 30.03.2018, është përdorur për shpenzime konsumi familjar. Shtetasi A.Sh. ka qenë shoferi i tij dhe në pamundësinë e tij fizike ka depozituar shumën 300.000 lekë në bankë me burim të ardhurat e tij personale dhe të familjes, për shlyerjen e kredisë. Shtetasit L.H., E.H. kanë qenë furnitorë që ka patur nga aktiviteti i tij privat dhe këto të ardhura janë pagesat të prapambetura, të cilat këto shtetase nuk i kanë shlyer. Aktiviteti i tyre është mbyllur në vitin 2014. Pas mbylljes gjithashtu të aktivitetit, shtetasit i detyroheshin një shumë rreth 200.000 lekë, të cilat i kanë shlyer me kalimin e viteve (2017 - 2019).”*

Subjekti paraqiti:

- **Vërtetim** i kryerjes së aplikimit për "Çregjistrim Person Fizik" dt. 25.11.2014, pranë QKR, të subjektit L.H., me NIPT K32808221A.
- **Mandat depozitimet bankare në Tirana Bank**, kryer nga E.H.,L.H. për Thodhori Gravani, me përshkrim "detyrim" në vlerën 20.000 lekë (referuar mandateve bankare, gjithsej 180.000 lekë).

Në proces-verbalin e datës 2.10.2023, subjekti paraqiti:

Deklaratë e shtetases L.H., e cila **konfirmon marrëdhënien tregtare** me shtetasin Thodhori Gravani. Bashkëlidhur karta e identitetit të L.H.. Vërtetim nr. *** prot., datë 29.09.2023 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për shtetasin A. Sh., i cili ka qenë punonjës me detyrë shofer pranë këtij institucioni, për periudhën 16.2018 - 01.01.2022.

Subjekti dha sqarime dhe paraqiti dokumentacion lidhur me transaksionet e konfirmuara nga Tirana Bank.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

Nga **pyetjet dërguar nga Trupa e Vlerësimit** mbi marrëdhëniet e subjektit me shtetasit L.H., E.H., subjekti sqaroi se me këto shtetase subjekti ka patur marrëdhënie biznesi dhe paraqiti dokumentacion justifikues mbi mundësitë e pagesave nga shtetasit e lartpërmendur.

Konkluzion:

- × **Trupa e Vlerësimit shqyrtoj provat shkresore të paraqitura nga subjekti për marrëdhëniet me shtetasit L.H, E.H nga ku rezultoi se provat e paraqitura nga subjekti nuk rezultojnë të sakta në lidhje me veprimtari tregtarë të përbashkëta.**

- ✗ Shtetasja L.H. me Nipt K32808221A sipas ekstraktit historik ka ushtruar veprimtari tregtare për transport udhëtarësh me mjet transporti 8+1 dhe nuk ka ushtruar aktivitete ekonomike në fushën e konfeksioneve, ndryshe nga seç pretendon subjekti.

AK Invest me shkresën nr. *** prot., datë 10.5.2023, konfirmon se shtetasi Thodhori Gravani në dt. 14.4.2019 ka transferuar shumën 15.000 lekë, në favor të shtetases B. K.

Në proces-verbalin e datës 17.7.2023, subjekti sqaroi se “shuma e transferuar ka qenë për një pretonim të pushimeve familjare”.

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

Në komunikim me emalin e datës 03.01.2024 me relatorin e çështjes ku subjektit ju kërkuan sqarime në lidhje me shtetases B.K., subjekti deklaroi se kjo shtetase kryente biznesin e dhënies së banesave në qira, pasi nga verifikimet e Trupës së Vlerësimit shtetasja B. K. rezultonte si punonjëse në DVKM Vlorë.

Subjekti i vlerësimit në komunikim me emalin e datës 03.01.2024 me relatorin e çështjes sqaroi se “shtetasja B.K. posedonte dhe jepte me qira një ambient afër portit të Sarandës. Për këtë më ka vënë në dispozicion dhe po ju paraqes fotokopje të kontratës së qerasë për banesën në qytetin e Sarandës që ka poseduar dhe në periudhën e verës e jepte me qira ditore”.

- ✓ Në lidhje me faktet e paraqitura, Trupa e Vlerësimit pranoj prapësimet e paraqitura nga subjekti të vlerësimit

DPSHTRR me shkresën nr. *** prot., datë 12.5.2023, konfirmon se shtetasi Thodhori Gravani ka patur në pronësi automjetin me targë AA71711Y.

Bashkëlidhur ndodhet:

- **Kontratë shitje pasuri e luajtshme** (automjeti) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.6.2020, palë shitëse Thodhori Gravani dhe palë blerëse E. M. të automjetit Daimler Crysler, targë AA****, kundrejt shumës 6.000 euro, vlerë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- **Faturë blerje dt. 25.11.2013**, në shtetin italian, drejtuar Thodhori Gravani dhe palë shitëse shoqëria "4 Ruote" srl, automjeti Daimler Crysler targë CL***VD, kundrejt shumës 6.900 euro, për eksport.

Bashkëlidhur deklaratës:

Kontratë kredie bankare nënshkruar në dt. 07.11.2013, ndërmjet Raiffeisen Bank dhe Thodhori Gravani, për vlerën e kredisë 704.000 lekë. Qëllimi i dhënies së kredisë është përdorimi i tyre për arsye "Preselected".

- Raiffeisen Bankë me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Thodhori Gravani, ku është disbursuar shuma 704.000 lekë.

Në proces-verbalin e datës 17.7.2023, të mbajtur nga ILDKPKI dhe verifikuar nga trupa e vlerësimit subjekti sqaroi se *"...të dhënat për automjetin i ka deklaruar që me deklarinimin e parë "Para fillimit të detyrës " në vitin 2015. Ka pasaktësi për vitin e blerjes, **nuk është Viti 2012, por Viti 2013, Për shkak të blerjes jashtë shtetit (Itali), nuk dispononte akt noterial shitblerje në dokumentacionin dhe në deklarime i referohej shumës prej 700.000 lekë, duke e lidhur me shumën e kredisë së aplikuar. Shuma e shpenzimeve për automjetin është 6.900 euro, duke shtuar dhe shpenzimet e zhdoganimit 197.694 lekë. E gjithë kjo shumë është përballuar nga tërheqja e shumës së kredisë prej 700.000 lekë dhe diferenca nga të ardhurat familjare."***

Deklarimi i automjetit është bërë në mënyrë periodike çdo vit, në deklarinimet e pasurisë, deri në momentin e shitjes më 22.06.2020, kundrejt shumës prej 6.000 euro; për këtë arsye nuk e ka ri deklaruar në "Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar. Subjekti sqaroi se kredia në Raiffeisen Bank është marrë për blerjen e automjeti Benz, me targë AA***HY.

Konkluzion:

- ✘ Në "Deklaratë e Pasurisë për Vlerësimin Kalimtar" Nr. Indeksi ***, viti 2023, Subjekti nuk e deklaruar mjetin me targa AA***HY në rubrikën e Deklarimit të Pasurisë dhe Burimi i Krijimit.
- ✘ Referuar deklaratës "Para Fillimit të Detyrës 2015" rezulton se automjeti deklarohet i blerë në vitin 2012, në vlerën 700.000 lekë.
- ✘ Në Deklarim i Pasurive pranë ILDKPKI, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë", kemi të bëjmë me të dhëna të pa sakta në deklarinim.
- ✘ Konstatohet se Automjeti Daimler Crysler, me targë AA****, është blerë në 25.11.2013 dhe shitur në dt. 22.6.2020, Automjeti i shitur nuk është deklaruar nga subjekti në "Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar".

✓ Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- **Nuk ka bërë deklarinim të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- **Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**
- **Nuk është kryer deklarinim i rremë;**
- **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

I. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

✚ Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

✚ Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit **z. Thodhori Gravani** me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

✚ **Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:**

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
- c. Korrespondencën me institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë.

✚ Drejtorja e Analizës dhe Sigurisë së Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore si organ ndihmës, në përputhje me nenin 42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, për vlerësimin e kontrollit të figurës ka dorëzuar nëpërmjet shkresës Nr.*** datë 20.07.2023 raportin e kontrollit të figurës⁵ ku ka konstatuar se:

- ✓ **Subjekti i vlerësimit z. Thodhori Gravani, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit., është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.**

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës subjekti ka deklaruar se:

- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka patur apo ka regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka pasur apo ka shtetësi tjetër.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë ndaj tij masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1990, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:

Në mbështetje të neneve 35-42 të ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar trupa e vlerësimit zhvilloj hetimin mbi kontrollin e figurës duke u bazuar në kthim-përgjigjet e institucioneve ligj zbatuese në Republikën e Shqipërisë, raportin e Drejtorisë së Analizës dhe Sigurisë së Personelit dhe deklaratimet e subjektit të vlerësimit **nga ku u konstatua:**

1. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “E paklasifikuar” nr. **** prot., datë 12.07.2023 për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani bën me dije se:
 - a. Nuk ka ndryshim të gjeneralitetëve
 - b. Nuk ka ndryshuar shtetësi (lenie ose marrje shtetësie)
2. **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** me shkresën “i kufizuar” nr. **** prot., datë 19.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani bën me dije se:
 - a. Nuk rezulton i dënuar
3. **Institucion Ligjzbatues** me shkresën “Sekret” Nr. **** prot., datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani bën me dije se:
 - a. Nuk disponon të dhëna.
4. **Institucion Ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. ****prot., datë 30.05.2023 dhe shkresë “e paklasifikuar” nr. **** datë 30.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani si dhe për personat e lidhur sipas certifikatës familjare nuk kanë:
 - a. Të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimin e ngritur në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
 - b. Të dhëna për kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar (*sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.95/2016 “për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*) ku mund të përfshihen biseda, foto, vëzhgime takimesh apo biseda telefonike etj.;
 - c. Të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*të dënuar ose proceduar penalisht, brenda apo jashtë territorit të republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë i ndryshuar.*);
 - d. Të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e ndonjë vepre penale;
 - e. Të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e ndonjë vepre penale.
 - f. Të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhër-arresti ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
 - g. Të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
 - h. Të dhëna për gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO.
 - i. Të dhëna që nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
 - j. Nuk ka procedime disiplinore apo masa disiplinore

5. **Institucion Ligjbatues**, me shkresën “Konfidencial” Nr. **** prot., datë 31.05.2023., për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani bën me dije se:
 - b. Nuk disponon të dhëna.

6. **Institucion Ligjbatues**, me shkresë “sekret” e datës 13.06.2023, shkresën “sekret” nr. **** prot., datë 13.06.2023 dhe shkresën “sekret”, nr. ****. prot, datë 19.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare bën me dije se:
 - a. Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të paligjshëm;
 - b. Nuk ka procedime penale të referuara;
 - c. Për subjektin e vlerësimit nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione;

7. **Institucion Ligjbatues**, me shkresën “i kufizuar”, nr. ****. prot, datë 10.07.2023 për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani bën me dije se:
 - a. Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
 - b. Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
 - c. Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo presonit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
 - d. Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprës penale;
 - e. Nuk ka pasur raste të urdhrit ndërkombëtar të ndalimit;

8. **Institucion Ligjbatues**, me shkresën “i kufizuar” nr. **** prot., 07.06.2023 bën me dije se, për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani:
 - a. Nuk rezulton të jetë regjistruar procedimi penal.

9. **Institucion Ligjbatues**, me shkresën “sekret” Nr. **** prot, datë 25.05.2023 bën me dije se për subjektin e vlerësimit Thodhori Gravani dhe personat e lidhur me të:
 - Rezultuan raportime, për të cilat pas verifikimeve të kryera janë të dhëna rutinore të raportuara nga bankat në kuadër të informim.

10. **Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën ‘i kufizuar’ nr. ****prot., datë 25.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani bën me dije se:
 - a. Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), niveli i klasifikimit “Tepër Sekret” lëshuar me datë 29.09.2021, të vlefshme deri në datën 28.09.2026.
 - b. Për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.
 - c. Nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

11. **Avokati i Popullit** me shkresën “e paklasifikuar” me nr. **** prot., datë 30.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani bën me dije se:

- a. Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- b. Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

12. **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit**, me shkresën “i kufizuar nr. *** prot., datë 08.06.2023 për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani, bën me dije se:

- a. Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 Korrik 1991.

Denoncime nga publiku

Për subjektin e vlerësimit z. Thodhori Gravani nuk është disponuar asnjë ankesë nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, me nr. ***, datë 11.01.2024, “Akt Ekzaminimi Toksikologjiko-Ligjor” konkludohet se subjekti vlerësimit z. **Thodhori Gravani:**

- ✓ **Nuk janë zbuluar prania e substancave narkotike.**

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Thodhori Gravani, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligj zbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit z. Thodhori Gravani:

- ***Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;***
- ***Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.***

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONAL

- Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.
- Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:
 - të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
 - raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar

Subjekti i vlerësimit **z. Thodhori Gravani** në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin **Drejtor i Drejtorisë së Protokollit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit**. Në momentin e hedhjes së shortit dhe përzgjedhjes së trupës së vlerësimit datë 05.04.2023 subjekti i vlerësimit mbante po funksionin e Drejtor në “Drejtor i Drejtorisë së Protokollit” në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

- Periudha e vlerësimit në zbatim të nenit 44 pika 2 të ligjit 12/2018 i ndryshuar është periudha 5-vjeçare (2018-2022). Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale do të shkrihet brenda këtij harku kohor.

C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT PROFESIONAL POLICIA E SHTESTIT.

Struktura e burimeve njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit si organ ndihmës për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr.12/2018 i ndryshuar ka dorëzuar nëpërmjet shkresës nr. 2645/53 datë 30.06.2023 raportin e vlerësimit profesional është shprehur me konkluzion përfundimtar si më poshtë vijon:

- Punonjësi i Policisë z. Thodhori Gravani është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës, si dhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave funksionale.**

C/2 HETIMI I TRUPËS SË VLERËSIMIT PRANË AGJENCISË SE MBIKËQYRJES POLICORE:

- ✚ Trupa e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me ligjin e vlerësimit si dhe ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, ka zhvilluar një hetim administrativ të plotë dhe të bazuar në fakte dhe prova duke u bazuar në:
 - Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit nr. 13822;
 - Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me nr. RMIS **9001597**;
 - Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1 të ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
 - Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.
- ✚ Punonjësi i Policisë, Drejtues i Parë Thodhori S.G. është emëruar në detyrë Drejtor i Drejtorisë së Protokollit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me urdhrin nr.*** datë 16.02.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
- ✚ Në zbatim të ligjit 12/2018 i ndryshuar, funksioni që mban z. Thodhori Gravani e bën atë subjekt të ligjit sipas nenit 6.

Vlerësimi i nivelit të arsimit.

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundimi	Vendi	Titulli/Diploma
Arsim i Lartë 4 vjeçar	Shkolla Larte Oficer Prapavije	1986	1990	Tiranë	Diplome
4 mujor i avancuar	Kurs kualifikimi te specialisteve të lartë me njohuri te përditësuar Ekonomi Tregu		2003	Tiranë	

- Trupa e vlerësimit administroj nga dosja e subjektit të vlerësimit diplomat:
 - a. **Diplomë nr.***, datë 15.07.1990** Shkolla e Lartë e Bashkuar e Oficerëve “Enver Hoxha”, me **specialitetin “Prapavijë”**.

Konkluzion:

- ✓ Trupa e Vlerësimit në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, konstaton se subjekti i vlerësimit gëzon nivelin e nevojshëm të arsimit për pozicionin e punës që mban.
- ✓ Në kuptim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që mban pranë Policisë së Shtetit.

- ✚ Hetimi i zhvilluar nga Trupa e Vlerësimit mbi pjesëmarrjen në konferenca shkencore, workshope seminare, të subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43-45 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

Certifikatat e trajnimeve, kualifikimet dhe medaljet:

- ✚ Trupa e vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstaton se gjatë periudhës 5 vjeçare të vlerësimit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar subjekti i vlerësimi ka marrë pjesë në trajnime “Planifikimi strategjik për sigurinë dhe zhvillimin”, “Mbi Planifikimin Strategjik për Sigurinë dhe Zhvillimin” organizuar nga “Cranfield University Britani”.

1. Ka realizuar trajnime;
2. Ka kualifikime.

- **Në lidhje me konstatimet e trupës së vlerësimit, me emalin e datës 12.01.2024**, “Disa sqarime ne lidhje me relacionin paraprak”, z. Thodhori Gravani, sqaron se “*gjatë periudhës së vlerësimit dhe konkretisht në vitin 2018 kam marrë pjesë dhe jam trajnuar si dhe pajisur me certifikatën përkatëse, “Mbi Planifikimin Strategjik për Sigurinë dhe Zhvillimin” organizuar nga “Cranfield University Britani”. Gjatë vitit 2019 kam marrë pjesë në trajnim në Turqi me tematikë “Përdorimin e lëndëve lakrimogjene nga Policia për menaxhimin e turmave”. Mbas atij trajnimi dhe në bashkautorësi nxorëm dhe vumë në përdorim për efektivet një libër manual me titull “Gazi CS, maskat dhe filtrat ne përdorim nga Policia e Shtetit”.*
- ✓ **Trupa e Vlerësimit konstaton se subjekti përgjatë periudhës së vlerësimit ka marrë pjesë në trajnime konferenca/ workshope/ seminare.**

Vlerësimet e punës:

Gjatë zhvillimit të hetimit mbi procesin e vlerësimit të aftësive profesionale trupa e vlerësimit ka konstatuar se:

- Për periudhën e vlerësimit (2018-2022) në dosjen e subjekti të vlerësimit dhe në raportin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, subjekti ka vetëm tre vlerësime pune atë të vitit 2018, 2021 dhe vitit 2022 me rezultat “**shumë mirë**”.

Konkluzion:

- ✓ **Trupa e vlerësimit konstaton se për vitet 2019 dhe 2020, eprorët e subjektit nuk kanë plotësuar vlerësime pune, sipas raportimeve të vetë institucionit.**
- ✚ Hetimi i zhvilluar nga Trupa e Vlerësimit mbi masat disiplinore të subjektit të vlerësimit në përputhje me nenin 43-45 të ligjit 12/2018 i ndryshuar.

Masat disiplinore

Trupa e vlerësimit në zhvillim të hetimit ka kryer verifikime në dosjen personale të subjektit të vlerësimit si dhe në sistemin RMIS, nga ku rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare, (2018-2022) të përcaktuar në pikën 2 të nenit 44 të ligjit 2018 i ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

- ✓ **Trupa e Vlerësimit konstaton se subjekti përgjatë periudhës së vlerësimit nuk ka asnjë masë disiplinore në ngarkim.**

Ecuria në karrierë

Nga verifikimi i të dhënave të deklarimit të subjektit të vlerësimit, raportit të vlerësimit profesional nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, subjekti i vlerësimit Thodhori Gravani ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 25 vitesh e 11 muaj. Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 5-vjeçare objekt deklarimi, subjekti mban:

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. urdhri	Data	
			Nga	Deri
Kryekomisar	Ri pranuar në Polici	Nr.***, datë 29.05.2015	29.05.2015	31.10.2016
Drejtues i Parë	Dhënë grada me vendim gjykate	Nr.***, datë 27.10.2016	01.11.2016	15.02.2018
Drejtues i Lartë	Emëruar Drejtor Departamenti	Nr. ***, datë 14.02.2018	16.02.2018	16.02.2022
Drejtues i Parë	Liruar nga detyra Drejtor Departamenti	Nr. *** datë 16.02.2022	17.02.2022	

Funksionet gjatë 5 viteve të fundit:

Data e fillimit	Data e përfundimit	Institucioni	Funksioni
17.02.2022	Aktualisht	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Drejtor i Protokollit
16.02.2018	16.02.2022	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Drejtor Departamenti Shërbimeve Mbështetëse

29.05.2015	16.02.2018	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Drejtore Mbështetëse Logjistike
------------	------------	--	---------------------------------

Policia e Shtetit konkludon se:

- ✚ Nga të dhënat e faktit konstatohet se subjekti i vlerësimit gjatë periudhës së vlerësimit ka mbajtur funksionin “**Drejtore**” në përputhje me kriteret ligjore dhe gradën që disponon. Funksionet dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore.

Hetimi i kryer nga trupa Vlerësuese:

- ✘ Trupa e vlerësimit në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të subjektit të vlerësimit z. Thodhori Gravani arrin në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe grada që ai ka përfituar, **nuk rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës**, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.
- ✚ **Me vendimin nr. ***, datë 01.06.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë**, punonjësi i policisë Thodhori Gravani nga Kryekomisar ka marrë gradën policore “Drejtues i Parë”.
- ✘ **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ka apeluar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë , në mënyrë që ky vendim të marrë formën e prerë për shkak të mos animimit**, në shkelje të procedurave standarde të punës që normojnë punën e strukturave policore.
- ✚ **Me urdhër Nr. ***, datë 14.02.2018**, “Për Emërimin në detyrë dhe dhënien e gradës policore Drejtues i Lartë një punonjësi policie”, të Ministrit të Brendshëm, subjekti ka marrë gradën **Drejtues i Lartë dhe është emëruar Drejtore Departamenti**.

Rezulton se me urdhrin Nr.***, datë 27.10.2016 ka marrë gradën Drejtues i parë dhe me urdhër Nr. ***, datë 14.02.2018 ka kaluar në gradën Drejtues i lartë. Siç parashikohet Ligjin e Policisë së Shtetit nr. 9749, datë 04.06.2007, në nenin 55, pika (ë), VI, kalimi nga grada nga “Drejtues i parë” në “Drejtues i lartë” ose “Drejtues madhor”, “...kërkon 2 vite qëndrim në gradë...”

- ✘ **Konstatohet se nuk ka mbushur afatin 2 vjeçar të qëndrimit në gradë.**

✚ Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se:

Subjekti i vlerësimit Thodhori Gravani:

- ✓ Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trainimin përkatës për funksionin;
- ✓ Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;
- ✓ Ka vlerësime pozitive pune.

Konkluzione përfundimtare:

Trupa e Vlerësimit të AMP, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, Trupa e vlerësimit konkludon se subjekti i vlerësimit kalimtarë nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi rezulton se pasuria e deklaruar nuk mund të justifikohet nga burime të ligjshme të ardhurash.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit të AMP, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi referuar nenit 59, germa “ç”, të si dhe nenit 62 germa “ç”, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Përrjashtimin nga detyra e subjektit të vlerësimit, Z. Thodhori Gravani.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, (të ndryshuar).
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë 26.01.2024.

KRYESUES

EDONA DUSHAJ

RELATOR

ANËTAR

ENTON RADOVANI

KLEADA MERSINLLARI